



EUROPEAN UNION

**Office of The Auditor General
Zyra e Revizionit Gjeneral
Kancelarija Generalnog Revizora**

UNMIK



Nr. dok.: 22.13.1-2006-08

**RAPORTI I AUDITIMIT TË PASQYRAVE FINANCIARE NË
KOMUNËN E RAHOVECIT PËR VITIN E PERFUNDUAR
2006**

Prishtinë, Dhjetor 2007

PERMBAJTJA

	LISTA E SHKURTESAVE	3
	PERMBLEDHJE E PERGJITHSHME	4
1	Hyrje	5
1.1	Korniza e Auditimit	5
1.2	Fushëveprimi i Auditimit në Rahovec për vitin 2006	5
1.3	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA)	5
1.4	Struktura e Raportit	6
2	Raportimi i Informatave Financiare	7
3	Çështjet që Ndikojnë në Opinionin e Auditimit	7
3.1	Opinionin e Auditimit	8
4	Sistemi i Kontrollit të Brendshëm	9
4.1	Auditimi i Brendshëm (AB)	9
5	Të hyrat	9
6	Shpenzimet	10
6.1	Paga dhe Mëditje	11
6.2	Mallrat, Shërbimet dhe Investimet Kapitale	11
7	Shpenzimet e Parasë së Imët(Petty Cash)	11
8	Menaxhimi Pasurise	11
9	Implementimi i Rekomandimeve nga ana e Menaxhmentit për vitin2005	12
10	Komentet e Komunës për Drafraportin e Auditimit	12
	Shtojca 1: Tabela e të gjeturave	13
	Shtojca 2 Komentet e Komunes	25

Lista e shkurtesave	Përshkrimi
ZF DKA	Zyrtari i financave i Drejtorisë komunale për arsim.
RDPP	Regjistrimi i të drejtave të pronës së paluajtshme.
AKK	Agjencioni Kadastral i Kosovës.
MAPL	Ministria e administrimit të pushtetit lokal.
KK	Kuvendi Komunal.
QKMF	Qendra komunale e mjekisë familjare (Rahovec).
MASHT	Ministria e arsimit ,shkencës dhe teknologjisë.
LPP	Ligji mbi prokurimin publik.
TVSH	Tatimi mbi vlerën e shtuar.
KEK	Korporata energjetike e Kosovës.

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Auditimi i pasqyrave financiare të Komunës së Rahovecit është bërë nga Zyra e Auditorit Gjeneral për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2006.

- Nuk është dhënë opinion për pasqyrat financiare të Rahovecit të vitit 2006. Arsyeja për këtë konsiston në faktin se pasqyrat financiare të Rahovecit kanë qenë të mangëta sa i përket:
- Nuk janë krijuar informata të mirëfillta me rastin e arkëtimit të hyrave në vendin e arkëtimit (në Burim)
- Nuk janë bërë harmonizime të informatave financiare për të hyrat e mbledhura midis Drejtorateve përkatëse dhe Drejtorisë të financave.
- Nuk ka të dhëna të sakta mbi gjendjen e pasurisë fikse (toka ndërtesa etj) me të cilën komuna e Rahovecit disponon, janë regjistruar vetëm një pjesë e pasurisë dhe inventarit.

Gjithashtu është vërejtur se:

- Procedurat e shpenzimeve, përfshirë prokurimin, pagesat dhe çështje të tjera kanë pasur devijime të rënda nga rregullat ligjore të kërkuara për ekzekutim.
- Komuna nuk ka sistem të kontabilitetit të dyfishtë dhe në përgjithësi çdo evidence është shumë e mangët dhe e krijuar në mënyrë shumë të pa përshtatshme për të qenë e qartë dhe e sigurt.

Te gjeturat, ndikimi dhe rekomandimet paraqiten nga auditori në Aneksin 1. ZRGJ i rekomandon menagjmentit të lartë të entitetit që të marrë masa korrigjuese në lidhje me këto rekomandime dhe në radhë të parë të paraqesë planin e tij të veprimit sa i përket adresimit të këtyre rekomandimeve 30 dite nga marrja e Raportit përfundimtar të auditimit.

Të gjeturat e rëndësishme që kanë të bëjnë me shpenzimet dhe të hyrat janë paraqitur në detaje në Aneksin 1 – Tabela e të Gjeturave.

1. Hyrje

Duke u bazuar ne Rregulloren e UNMIK-ut nr.2001/9 Për Kornizën Kushtetuese te Vetëqeverisjes se Përkohshme ne Kosovë kreun 8.1(e) dhe (x) kreun 11.1 (c) . si dhe ne Rregulloren e UNMIK-ut 2002/18 mbi Themelimin e Zyrës së Revizorit te Përgjithshëm dhe Zyrës se Revizionit te Kosovës nenin 3.2 dhe 4.4. ne kemi kryer auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës se Rahovecit për periudhën prej 01.01.2006 deri me 31.12.2006.

1.1 Korniza e Auditimit

Sipas nenit 3.2 te Rregullores Nr.2002/18 Zyrës se Revizionit Gjeneral (ZRGJ) i kërkohet të kryejë një auditim te përvitshëm te rregullsisë te te gjitha Institucioneve te Kosovës , përfshire:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pasqyrë të vërtetë dhe të drejtë;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Përshtatshmëria e kontrolleve të brendshme dhe funksioneve të auditimit të brendshëm.
- Ndershmërinë dhe drejtësinë e vendimeve administrative të zbatuara në kuadër të institucionit ose të entitetit që iu është nënshtruar auditimit; si dhe
- Të gjitha çështjet që rrjedhin nga auditimi apo kanë të bëjnë me të.

Në muajin mars të vitit 2003, Kuvendi i Kosovës e ka nxjerr Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP), nr. 2003/2 i cili ligj edhe formalisht është shpallur nga Perfagesuesi special (PSSP) me Rregulloren nr 2003/17 të datës 12 maj 2003.

1.2 Fushëveprimi i Auditimit në Komunën e Rahovecit për vitin 2006

Objektivi primar i këtij auditimi është që t'i mundësohet ZRGJ-së që ta japë opinionin nëse pasqyrat financiare të Komunes se Rahovecit japin një pasqyrë të vërtetë dhe të drejtë për të hyrat e arkëtuara dhe shpenzimet e kryera gjatë vitit i cili ka përfunduar më 31 dhjetor 2006, si dhe nëse janë përgatitur në pajtim me Standardet ndërkombëtare të kontabilitetit të sektorit publik (SNKSP) lidhur me" raportimin financiar sipas kontabilitetit të parasë së gatshme". SNKSP-të janë nxjerrë nga Bordi i standardeve ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik (BSNASP) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK).

1.3 Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA)

Pasqyrat financiare të komunës se Rahovecit për vitin 2006 kanë qenë subjekt i auditimit të pavarur i cili është realizuar në pajtim me Standardet nderkombetare te kontabiliteti (SNK)-të e Bordit të standardeve ndërkombëtare të auditimit, i cili funksion si organ i veçantë në kuadër të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve(FNK) të standardeve ndërkombëtare të zbatueshme për sektorin publik. Këto standarde e përcaktojnë kornizën ndërkombëtare sipas së cilës Zyra e Revizorit Gjeneral duhet t'i kryejë detyrat dhe t'i përfshijë çështjet siç janë, parimet dhe përgjegjësitë e përgjithshme, vlerësimi i rrezikut dhe përgjigjet ndaj rreziqeve të vlerësuar, dëshmitë e auditimit, mbështetja në punë e të tjerëve dhe konkluzionet si dhe raportimi i auditimit.

Standardi i caktuar Ndërkombëtar i Auditimit që përcakton konkluzionet e auditimit dhe të raportimit, siguron formën dhe të shprehurit standard i cili duhet të adoptohet kur një auditor jep një opinion të qartë ose të pandryshuar të auditimit, si dhe udhëzojnë se kur një auditor duhet të japë një opinion të kualifikuar ose të modifikuar të auditimit.

Një opinion i modifikuar i auditimit duhet të jepet për këto situata vijuese:

Kur auditori vjen në përfundim që sipas të dhënave të marra të auditimit, pasqyrat financiare nuk janë pa gabime materiale për shkak të mospajtimit me menaxhmentin lidhur me (i) pranueshmërinë e politikave të zgjedhura të kontabilitetit, (ii) zbatimin e politikave të zgjedhura të kontabilitetit ose (iii) përshtatshmërinë e shpalosjes në pasqyrat financiare. Prandaj, auditori vjen në përfundim që pasqyrat financiare nuk janë përgatitur nga të gjitha aspektet në pajtim me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar; apo kur auditori nuk mund të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe përkatëse të auditimit për të arritur në përfundim që pasqyrat financiare janë pa gabime materiale.

Pas kësaj, auditori e jep gjykimin profesional lidhur me materialitetin dhe shtrirjen e ndikimit të çështjes duke i dhënë rëndësi ndryshimit për marrjen e vendimit lidhur me llojin e opinionit i cili duhet të lëshohet, si në tabelën më poshtë:

Tabela 1

Natyra e çështjes e cila i jep rëndësi ndryshimit	Ndikimet ose ndikimet e mundshme të pasqyrave financiare	
	Materiale	Materiale dhe ndikuese
Mospajtimi me udhëheqjen	Opinion i kualifikuar	Opinion i kundërt
Pamundësia për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe përkatëse	Opinion i kualifikuar	Refuzim i opinionit

Nga kjo rrjedh që refuzimi i opinionit lëshohet atëherë kur auditorët nuk mund të përcaktojnë nëse zërat e renditur në pasqyrat financiare janë apo mund të jenë të ndikuara nga pamundësia e tyre për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe përkatëse dhe për shkak që është vështirë ose e pamundur për ata që t'i përshkruajnë qartë ndikimet lidhur me pasqyrat financiare në raportet e tyre të auditimit. Kështu, për pasqyrat financiare nuk është dhënë asnjë opinion.

1.4 Struktura e Raportit

Hyrja në kaptinën 1 shoqërohet me kaptinat vijuese të cilët shtjellojnë këto pika:

Kaptina 2	Raportimi i informatave financiare
Kaptina 3	Çështjet të cilat ndikojnë në dhënien e opinionit
Kaptina 4	Sistemi i kontrollit të brendshme
Kaptina 5	Të hyrat
Kaptina 6	Shpenzimet
Kaptina 7	Menaxhimi i pasurisë
Kaptina 8	Zbatimi i rekomandimeve për vitin 2005.

Të gjeturat e rëndësishme të auditimit të përfshira në raport janë ilustrime të çështjeve kyçe që janë gjetur gjatë auditimit të komunës, por që nuk duhet të merren se mund t'i shpalosin të gjitha çështjet e gjetura gjatë procesit të auditimit.

2. Raportimi i Informatave Financiare

Kemi audituar pasqyrat financiare të Komunës-Rahovecit për vitin 2006. Këto pasqyra janë përgjegjësi e menaxhmentit të Komunës-së, kurse përgjegjësia e auditorit është që të jap një mendim për këto pasqyra. Afati i fundit për raportim ka qenë 31 janar 2007.

Departamenti i Thesarit në MEF e ka nxjerr Udhëzimin Administrativ nr. 2006/14 Raportimi vjetor i Organizatave Buxhetore për entitetet të cilat financohen nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës. Sipas kiti Udhëzimi entitetet obligohen që ta paraqesin raportin financiar për parane e gatshme sipas Standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit të sektorit publik. Neni 6 si më i rëndësishmi është paraqitur në vijim:

6.1 Pasqyra financiare e organizatave buxhetore duhet të ketë strukturën në vijim:

- a) Bilancin e gjendjes
- b) Pasqyrën e të hyrave dhe shpenzimeve
- c) Pasqyra e ekzekutimit të buxhetit
- d) Pasqyra e ndryshimit të ndarjeve
- e) Te hyrat
- f) Shënimet shpjeguese
- g) Pasqyrat e paradhënies të pa arsyetuara dhe Huazimet
 - (i) Pasurit jo ne para dhe Detyrimet
 - (ii) Pasqyra e faturave të papaguara
 - (iii) Pasqyra e detyrimeve kontingjente

3. Çështjet që Ndikojnë në Opinionin e Auditimit

Çështjet kyçe të cilat ndikojnë në dhënien e opinionit të Zyrës së Revizionit Gjeneral (ZRGj-së) për pasqyrat financiare të komunës për vitin 2006 janë si në vijim:

Nuk ka të dhëna të sakta mbi gjendjen e pasurisë së komunës.

Nuk ofrohet evidence e saktë nga departamentet që krijojnë (mbledhin) të hyra.

Mungojnë harmonizimet në mes të drejtorive që inkasojnë të hyra dhe

Departamentit të Financave që i regjistron këto të hyra.

Mos shpalosja në Pasqyrat Financiare (PF) e gjendjes së mjeteve në fund të vitit 2006 për tri llogari bankare të Çerdhes së fëmijëve.

Mos shpalosja në PF e kërkesave të shlyera nga të hyrat për qira në vlerë 152,697.21 euro. Procedurat e shpenzimeve, përfshirë prokurimin, pagesat dhe çështje të tjera kanë qenë të shoqëruara me devijime të renda në përputhje me rregullat ligjore të kërkuara për ekzekutim.

Në rastet e mundshme ZAP-ja tenton të kuantifikoj paqartësitë dhe gabimet në llogaritë e pa-audituar, duke u bazuar në dëshmitë e ofruara. Të gjetura kyçe për parane e gatshme në bankë, të hyrat, prokurimet, shpenzimet e tjera, paga dhe mëditje, parane e imët,

subvencionet dhe menaxhim të pasurive janë paraqitur në Aneksin 1. ZRGJ shfrytëzon rastin t'i prezantojë rekomandime të hollësishme Menaxhmentit të Lartë. Për këtë entitet, ne kemi përcaktuar nivelin vijues të paqartësive dhe gabimeve:

Tabela 2: Paqartësitë dhe Gabimet e kuantifikuara në Komunën e Rahovecit 2006

	Vlera ne PF në euro	Jo-pajtueshmëri me rregulloret	
		Paqartësitë në euro	Gabimet në euro
I. Të hyrat	782,835	152,697	2175
II. Shpenzimet:	4,662,056	0	0
- Pagat dhe mëditjet	2,846,748	0	0
- Mallrat dhe shërbimet	627,079	32,533	0
- Investimet kapitale	902,210	601,239	0
- Komunalet	215,427	0	0
- Subvencionet dhe transferet	70,735	0	0
Totali	5,444,891	786,469	2175

Vërejtje, që për komunën domethënia e këtyre të gjeturave mund të jetë më e madhe sesa ajo që paraqitet në tabelën e paqartësive dhe gabimeve të komunës. Këto janë vetëm gabimet dhe paqartësitë të cilat janë kuantifikuar dhe se kjo tabelë është vetëm pjese e opinionit të përgjithshëm për entitetin.

3.1 Opinioni i Auditimit

Për shkak të rëndësisë së çështjeve të përmendura në paragrafët më lartë, nuk kemi qenë në gjendje ta japim opinion sa i përket pasqyrave financiare të komunës për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2006.

Ende nuk është arritur që të dizajnohen mënyra të evidencës se mirëfillte të dokumenteve dhe të hyrave dhe shpenzimeve .

Veç kësaj, ekzistojnë çështje të tjera serioze lidhur me të hyrat, shpenzimet, menaxhimin e pasurive dhe procedurat e prokurimit, që kërkojnë vëmendjen e menjëhershme të menaxhmentit të komunës. Këto janë të referuara në Aneksin 1.

4. Sistemi i Kontrollit te Brendshëm

Në përgjithësi, Komuna e Rahovecit ka një sistem kontrolli të brendshëm që është i pa efektshëm.

Kemi vërejtur dobësi në çështjet e raportimeve të te hyrave brenda përbrenda komunës.

Te hyrat nuk kanë një evidence të mirëfilltë që nga burimi dhe nuk bëhen harmonizimi ndërmjet sistemit të raportimit.

Pothuajse asnjë mekanizëm adekuat nuk është ngritur për kontrollin e cilësisë së punës së stafit në fusha të ndryshme, në veçanti të verifikimit, harmonizimet e dokumenteve dhe parave të mbledhura.

Nuk ka dizajnim të mirëfillte të dokumenteve

4.1 Auditimi i Brendshëm (AB)

Gjate vitit 2006 është ndërruar stafi i auditorit të brendshëm, ka pasur disa raporte nga auditori i me hershem si dhe nga auditori i cili është emëruar me vone. Këto raporte nuk kanë pas asnjë efekte në përmasimin e te metave në sektorët përkatës, te metat në përgjithësi kanë mbete ashtu siç kanë qene si në fushën e te hyra ashtu edhe te shpenzimeve

Auditori brendshëm i emëruar në 2006 nuk ka pasur asnjë trajnim në fushën e auditimit

Auditori nuk është kontabilist i certifikuar apo auditor i licencuar.

Njësi të Auditimit të Brendshëm nuk ka as Statut të auditimit e as udhëzim të auditimit, që bashkërisht përfshijnë metodologjitë e auditimit, procedurat, përgjegjësitë, mekanizmat raportues, kodin e etikës dhe deklaratën e konfliktit të interesave.

5. Të hyrat

Objektivë në këtë rast ka qene të vlerësojmë arkëtimin e të hyrave nga komuna në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës për vitin 2006 si dhe identifikimi i përmirësimeve të mundshme në arkëtim.

Te hyrat kryesore që arkëtohen nga komuna janë:

- Te hyrat nga tatimi në pronë.
- Të hyrat nga regjistrimi i pronës dhe transferimi i sajë.
- Të hyrat nga dhënia e lejeve për ndërtim.
- Të hyrat nga dhënia e Licencave për regjistrim të biznesit.
- Të hyrat nga participimet e qytetarëve në shëndetësi.
- Të hyrat nga gjobat e trafikut.
- Të hyrat nga taksat administrative etj.

Tabela 2. Te hyrat e komunës së Rahovecit për vitin 2006 të paraqitura në Pasqyrat Financiare

Përshkrimi	Vlera në euro
Te hyrat vetjake	782, 836
Granit i Qeverisë	4 ,094, 903
Fondi i donatorëve	133 ,668.
Totali i te hyrave	5 ,011, 407

Te gjeturat kyçe në kategorinë e të hyrave qe karakterizon të gjitha Drejtoritë në komunë është se:

- Nuk është krijuar një baze e mirëfillte e shënimeve për qëllime financiare ndonëse këto shënime mbahen në Excel Megjithatë kjo evidence nuk është e përshtatshme dhe nuk i përngjanë bazës se të dhënave të mirëfilltë
- Sistemi i kontrollit është i dobët për të siguruar plotësinë e të hyrave të mbledhura dhe korrektësinë pasuese të regjistrimit të hyrave të raportuara.
- Nuk janë zbatuar komplet procedurat për mbledhjen e borxhit, për të minimizuar në këtë mënyrë humbjet potenciale të hyrave në komunës dhe përfundimisht edhe në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës (BKK)
- Nuk dihet numri i saktë i dokumenteve të lëshuar për përfituesit e kategorive të liruar nga obligimet.
- Nuk përgatiten barazime të hollësishme mujore në mes të shumave të depozituara dhe regjistrave burimore.

Të gjeturat tjera përfshijnë:

- Mos shpalosja në Pasqyrat Financiare e kërkesave të shlyera për të hyrat nga qiraja në vlerë 152,697.21 euro
- Nuk janë raportuar të hyra nga Çerdhja e fëmijëve (Tulipanet) as në departamentin e arsimit dhe as në pasqyrat financiare.

Këto të gjetura janë paraqitur hollësisht në aneksin 1

6. Shpenzimet

Tabela 3, Shpenzimet e komunës së Rahovecit sipas pasqyrave financiare për vitin 2006

Përshkrimi	Vlera në euro
Kompensimet e punëtorëve	2,846,748
Mallrat e Shërbimet	842,506
Subvencionet dhe transferet	70,735
Shpenzimet kapitale	902,210
Totali i prezantuar nga pasqyrat financiare	4 662 ,056

Te gjeturat e rëndësishme janë paraqite në mënyrë të hollësishme në Aneksin 1

Disa prej grupeve më të rëndësishme janë :

- Mos bërja e zotimeve me kohë për shpenzimet e ndryshme
- Mungon autorizimi me shkrime për fillimin e procedurave të prokurimit
- Raporte të pranimit të mallrave nga njerëzit jo profesioniste .Ka raste kur raporti mungon fare .
- Gjithashtu ka raste ku është shkruar raporte për punët të cilat kurrë nuk janë kryer. Në këtë mënyrë është bërë kërkesë për tu kryer pagesa për punët e pa kryera
- Mungojnë procesverbalet e vlerësimit të ofertave si dhe vendimi për formimin e komisioneve të vlerësimit
- Urdhër blerjet janë aprovuar nga zyrtari aprovues ,jo nga zyrtari i prokurimit
- Numri i ofertave të pranuar shpesh ka qenë në minimum 3 në gjetëm rastin kur të tri ofertat ishin me çmim të njëjtë.

- Ne specifikacione teknike komuna disa raste ka caktuar vete vlerën e mallit te kërkuar,
- Janë konsideruar si te përgjegjshme për ndërtim kompania qe ka qene me veprimtari jo përkatëse- hoteliere,
- Përshkrimi i urdhërpagesës nuk i përgjigjet situacioneve për te cilat paguhet dhe atë të përshkrimit te faturës,
- Komuna ka aprovuar projektin e ofruar nga komuniteti pa e rishikuar .Për shkak te gabimeve ne projekte janë shkaktuar pune shtese te cilat komuna nuk ishte ne gjendje ti llogarite se sa ishte vlera e tyre ,
- Janë pranuar punët shtese pa aprovimin e Agjencionit te Prokurimit Publik (APP) për punët shtesë.

6.1 Paga dhe Mëditje

Komuna e Rahovecit gjatë vitit 2006 nuk ka pasur rekrutime te reja të punëtorëve. Gjate vitit 2006 ka pasur paga te cilat i janë paguar punëtorëve edhe pse te njëjtit kane dhënë dorëheqje. Dosjet e personelit nuk ishin te kompletuara me dokumentet te cilat tregojnë për gradimin e punëtorëve ,po ashtu kishte kontrata (prej 7 mostrave 3ishin te pa nënshkruara) qe ishin te pa nënshkruara nga punëtorët ,Pagat ne kontrate dhe ne listën pagave ishin te ndryshme ,nuk gjetëm vendimet për rritjen e pagave.

6.2 Mallrat, Shërbimet dhe Investimet Kapitale

Në këtë fushë ZAGJ-ja ka marrë këto mostra:

Tabela 4: Mostra e prokurimit

Lloji i projektit (Popullacioni)	Totali i projekteve	Mostrat e zgjedhura
Te marra nga evidenca e free Ballace		4
Kontratat e mëdha (me vlerë mbi 10.000 euro)	77	5
Kontratat përmes procedurave te kuotimit te çmimit ; (me vlerë nga:500 - 10.000€)		4
Blerjet me vlerë të vogël (më pak se; 500 euro)	24	3

7. Shpenzimet e Parasë se Imtë (Petty Cash)

Pas rishikimit të zbatimit të procedurave për shpenzimin e parasë se imtë dhe pas testimit të mostrave nuk kemi gjetur ndonjë parregullsi të rëndësishme.

8. Menaxhimi i Pasurisë

Gjate auditimit kemi konstatuar se komuna mban një lloj evidence te një pjese te pasurisë siç është inventari kompjuterët dhe automjetet .Për pjesën ma te madhe te pasurisë nuk ka evidence për pasuritë siç janë ndërtesat , shume lokale tjera afariste ,token etj.

Gjate auditmit ne gjetëm se nga pasuria e pa regjistruar dhe e pa paraqitur ne pasqyrat financiare një pjese e kësaj pasurie është pasuri faktike e komunës ndërsa një pjese tjetër komuna i kishte marr ne mbikëqyrje për te ruajte nga dëmtimet e kujdoqofte . Mirëpo

regjistrimi i pasurive në përputhje me Instruksionin administrativ 2005/11 Menaxhimi dhe Regjistrimi i Pasurive Qeveritare nuk është kryer për pjesën me te madhe të pasurive. Kërkesat e këtij Instruksioni kanë filluar të implementohen gjatë të vitit 2005. Në Instruksion kërkohet që brenda 45 ditësh të behët i gjithë regjistrimi i pasurive, megjithatë komuna ende deri sot nuk ka arritur të evidentoj të gjithë pasurinë që ka në pronësi të sajë.

Komuna nuk ka rregullore që rregullon përdorimin e automjeteve ,automjetet janë ndare neper departamente dhe menaxhohen nga drejtorët e departamenteve

Në rast të servisimit të automjeteve komuna nuk kontrollon dhe nuk krijon raporte të pranimit të serviseve. Nuk sigurohet se ato pjesë, vërtetë janë ndërruar.

Zyrtari i pasurisë ka filluar me plotësimin e formularëve për regjistrimin kontabël të pasurisë në thesar, por ende nuk ka arrit të evidentoj vlerën e sakte të pasurisë.

Komisionet e regjistrimit dhe vlerësimit të pasurisë janë formuar në vitin 2006, ku kanë bërë regjistrimin dhe vlerësimin e pasurisë së Komunës.

Zgjedhja e mostrave për ekzaminimi fizik të pasurisë është bërë në bazë të gjykimit profesional të auditorit Kemi testuar pasurinë në lokalet e komunës. Personi i autorizuar nuk ishte në gjendje të identifikoj mjetet e kërkuara për shkak të përshkrimit gjysmak të pasurive

9. Implementimi i Rekomandimeve nga ana e Menaxhmentit për vitin 2005

Pas marrjes së rekomandimeve nga ana e auditimit të vitit 2005 Kryeshefi ekzekutiv ka hartuar disa politika të cilat do të shkonin në drejtim të implementimit të rekomandimeve mirëpo në përgjithësi nuk ka ndryshuar asgjë në përparimin e mirëfunksionimit të përgjithshme të komunës së Rahovecit

Gjatë vitit 2006 komuna nuk ka arritur të bëjë implementimin e rekomandimeve të dhëna.

10. Komentet e Komunës Për Draft Raportin e Auditimit

Komunës i është dhënë mundësia për komente në Draft Raportin e auditimit në mënyrë që të eliminohet rreziku i keqinterpretimit dhe keqkuptimit në mes të ekipit të auditimit dhe entitetit të audituar.

Ka pasur komente nga Komuna të cilat janë paraqitur në Aneks 2

Auditorët i kanë shqyrtuar komentet e Komunës ku disa nga to edhe i kanë pranuar si dhe janë bërë ndryshime përkatëse në raport nga ana e ZRGJ-së.

Shtojca 1: Tabela e te gjeturave

Nr	Te gjeturat	Ndikimi	Rekomandimi
I	Te Hyrat		
	Te hyrat nga arsimi		
1	Ky drejtorat realizon te hyra nga ditimet e fëmijëve. Janë kryer rishikime të hollësishme mbi besueshmërinë e procedurave dhe kontrolleve për të hyrat nga drejtorati. Nga rishikimi vërejtëm se nuk ka pasur raportim nga çerdhja e fëmijëve ,Tulipanët,, ne Drejtoratin e arsimit, si dhe këto te hyra nuk janë përfshi ne pasqyrat financiare. Çerdhja e fëmijëve kishte të hapur llogari bankare personale në emër të Drejtoreshës së çerdes.	Sistemi i kontrollit është i dobët për të siguruar plotësin e të hyrave të mbledhura dhe korrektësinë pasuese të regjistrimit të hyrave të raportuara. Menaxhim jo kompetent i pasurisë publike dhe dëmtim i buxhetit komunal. Komuna nuk ka bërë shpalosje në PF të vitit 2006 për llogaritë bankare personale për mjetet e komunës.	ZRGJ rekomandon qe te mbahet evidence e mirëfilltë dhe te bëhen raportime ne departamentin përkatës si dhe te gjitha te hyrat te përfshihen ne PF
	Te hyrat Kadastrale		
2	Mungon një evidencë e përgjithshme e lëndëve të proceduara gjatë vitit 2006	Mungesa e evidencave bën të pa mundur qe komuna të këtë shënime të sakta dhe të plota në lidhje me lendet e proceduara dhe të hyrat e inkasuara.	ZRGJ rekomandon qe Menaxhmenti te angazhohet që të udhëhiqen evidenca të sakta dhe te hollësishme për të gjitha lëndët e proceduara.
3	Me rastin e bartjes se pronës dhe regjistrimit të sajë pala është e obliguar të paguajë dy lloje të tarifave. Një tarifë paguan në përputhje me Udhëzimin administrativ të Agjencionit Kadastral të Kosovë (AKK).2006/1. Një tarifë tjetër paguan në përputhje me vendimin e Për Përcaktimin e Nivelit te Pagesave për Shërbimet e bëra për regjistrimin e te te drejtave te Pronave te Paluajtshme te nxjerre nga Agjencia Kadastrale e Kosovës.	Dëmtim i taksapaguesve ne forme te dyfishtë. Mos harmonizim i rregullatives ligjore, ne këtë rast Udhëzimit administrativ nr. AKK 2006/1 i Agjensionit Kadastral me Rregulloren nr. 320 Mbi kriteret dhe lartësinë e kompensimit të tarifave,	ZRGJ rekomandon qe Komuna duhet te harmonizojë Rregulloren nr. 320 mbi kriteret dhe lartësinë e kompensimit të tarifave komunale me Udhëzimin administrativ nr. AKK 2006/1 i Agjensionit Kadastral dhe te përcaktoj një tarife të përbashkët për shërbimin e kryer.
4	Në mostrën " Aktvendimi nr 193, i datës 03.07.2006 pala është ngarkuar me shumë se që ka qenë I obliguar me Udhëzim administrativ AKK. 2006/1. Sipas këtij Udhëzim pala ka qenë e obliguar të paguaj vetëm 20 euro, ndërsa komunës I ka paguar 100 euro.	Dëmtim i taksapaguesit. Procedim i pagesës për transferim e pronës në kundërshtim me tarifat e përcaktuara nga Udhëzimi administrativ AKK-2006/1.	ZRGJ rekomandon qe të zbatohet përpikmerisht Rregullativa ligjore përkatëse.
	Të hyrat nga Urbanizmi (Janë testuar 4 mostra)		
5	Në mostrën nr. 12 nr.215/1, te datës 09.10.2006 dhënie e lejes se ndërtimit nuk është kalkuluar siç kërkohet me dispozita ligjore. Kalkulimet kanë të bëjnë me pjesën e Bodrumit-objekti me themelet ekzistuese. Është aplikuar një tarifë e cila nuk është e parapare me Rregulloren mbi lartësinë e tarifave, Tarifa nr. 2,	Kjo paraqet mos respektim te Tarifave komunale te përcaktuara me dispozita ligjore te komunës.	ZRGJ rekomandon që të rishikohet dhe të sqarohet ky rast, si dhe të respektohen në përpikmëri tarifat e përcaktuara me dispozita ligjore.

	ngarkesave dhe kompensimin për shërbime komunale. Komuna nuk ka një rregull të tillë.		
	Te hyrat nga Qiraja		
6	Janë dhëne lokale të ndryshme me qira në vlerë të cilave është shumë herë më e vogël në krahasime me normat e caktuara në rregulloret e komunës 01Nr 13 dt 7 Mars 2006, Kjo vlerë në disa raste arrihet në shumën prej 0.12 cent për metër katror ndërsa në tarifën e komunës vlera ishte 2.5 euro për metër katror (Kontrata me „OLT,,).Po ashtu kemi vërejtur se ka pas shlyerje të kërkesave(obligimeve të qiramarrësve) ndaj Komunës Kështu janë shlyer obligimet e qiramarrësit “OLT” në vlerë 14,750 euro dhe qiramarrësit Kompanisë AEE HOLDING i janë shlyer në vlerë 137,947.21 euro	Shlyerja e kërkesave për qira ndaj obliguesve(shfrytëzuesve të pasurisë komunale) është dështim i Komunës në mbledhjen dhe ruajtjen e parave publike si dhe dëmtim i buxhetit komunal në vlerë 152,697.21 euro. Veprimet e tilla nuk përshtaten me kërkesat e nenit 10.2 pika e) e LMFP si dhe nenit 1 dhe 6 të Rregullores mbi lartësinë e tarifave,ngarkesave dhe kompensimeve për shërbime komunale 01Nr 13. Vjelja dhe vjelja e detyruar e të hyrave nga qiraja në komune kërkon angazhim shumë më të madhë për inkasim. Shlyerja e qerave shkakton jo transparencë dhe mosbarazim për pagesat tjerë të cilat kanë qenë të rregullt në pagesa	ZRGJ rekomandon që Menaxhmenti i Komunës fuqimisht të angazhohet të zbatojë në praktikë kërkesat e LMFP dhe të Rregullores mbi lartësinë e tarifave,ngarkesave dhe kompensimeve për shërbime komunale 01Nr 13.
7	Kontratat me koncesion(kontrate për „Hotel Park „ me firmën „ Gastrokos,, janë jo saktë të precizuara(neni 2 i kontratës saktëson çmimin për m2 por nuk saktëson se sa metra katror janë në shfrytëzim. Mandej në nenin 7 të kontratës lenë hapësirë për konflikte të interesit ku thuhet se Organin mbikëqyrës të caktuar nga Komuna duhet ta paguë qiramarrësi i objektit dhe shpenzimet do të llogariten në shumën e investimit). Kontratat si të tilla i japin shkas qiramarrësi që të bëjë deklaratime jo të sakta(pa dëshmi mbështetëse dhe jo të verifikuara nga ekspertë të pavarur) për investimet e veta të bëra në objektet e marra me qira nga komuna.	Mos prezantimi i dëshmive dhe mos verifikimi nga ekspert të pavarur mbi investimet e bëra në objektet komunale nga ana e qiramarrësit ekziston rreziku i mbivlerësimit të investimeve dhe zvogëlim pa meritë dhe jo i ligjshëm i të hyrave komunale.	ZRGJ rekomandon që Menaxhmenti i Komunës të kujdeset që të gjitha investimet të cilat bëhen nga ana e qiramarrësit duhet të përcillen nga komisionet profesionale të caktuara nga Komuna dhe të verifikohen nga ekspert pavarur dhe mandej të pranohen sipas kushteve të kontratës nga ana e Komunës. Te precizohet vlera e investimeve në krahasim me qiranë në periudha mujore dhe vjetore
	Të hyrat nga participimet e qytetarëve në shëndetësi		
8	Nuk bëhen harmonizime midis librave të protokollit shëndetësor, bllokave të fletëpagesave dhe Raporteve të tjera Financiare.	Mosbarazimi i të dhënave nuk jep siguri se ka evidencë të saktë dhe të kompletuar . Kjo nuk i mundëson komunës për të bërë administrimin sa më të mirë për të hyrat dhe si qëllim i fundit mbledhjen e tyre. Derisa komuna nuk Ben harmonizime të tilla,	ZRGJ rekomandon që Departamenti i shëndetësisë të kryejë harmonizimin e të dhënave në baza ditore në mes të Librave të Protokollit, bllokave të fletëpagesave dhe raporteve tjera financiare

		informatat e dhëna do të jenë të pabesueshme.	
9	Dokumentacioni për mbledhjen e të hyrave (Blok pagesat), nuk janë raportuar ashtu siç është e paraparë me kornizën Ligjore (25 Bllok pagesa të tillë, të cilët i përkasin vitit 2006 nuk janë kthyer deri në ditën e kryerjes së auditimit). Te pakthyer deri ne këtë këtë kohe janë edhe 18 bllok pagesa të tilla kryesisht të periudhës para vitit; 2002-3-4-5. Vlera minimale e një bllok pagese është; 50 euro. Periudha e kthimit ishte shumë me gjatë se që ishte e paraparë dhe e kërkuar për kthimin e tyre).	Mos kthimi me kohë i dokumenteve të mbledhjes së të hyrave rezultoi me mos deklaram të të hyrave të mbledhura dhe dëmtim të buxhetit komunal. Kjo është në kundërshtim me Ligjin e Menaxhimit të Financave Publike, nr. 2003/17 Neni 13.4.	ZAGJ i rekomandon Menaxhmentit që të ndërmarrë masa urgjente për kthimin e bllok pagesave dhe parave të mbledhura. Paratë e mbledhura nga ato të hyra duhet të bartë në Llogaritë Publike të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës ashtu siç kërkohe sipas Kornizës Ligjore..
10	Kemi bërë testimin e sistemit të evidentimit të të hyrave në shtëpinë e shëndetit në Rahovec dhe në punktin shëndetësor në Fortesë. Nga rishikimi vërejtëm se nuk krijohet evidence baze e përshtatshme për të dhëne një pasqyre të qartë për shumën e të hyrave të mbledhura nga participimi në shëndetësi. Personeli që bënë arkëtim nuk e dinë se sa të hyra i ka inkasuar gjatë një muaji ose gjatë tërë vitit. Nuk bëhet harmonizimi me nivele tjera të raportimit	Mungesa e një evidence të mirëfilltë dhe e harmonizimeve të shënimeve midis Sektorit të financave dhe Sektorit të Shëndetësisë, i bënë të papabesueshme këto të dhëna.	ZRGJ rekomandon që Menaxhmenti duhet të përmirësojë dizajnin e dokumenteve për evidence në mënyrë që të dihet saktë shuma e mbledhur e parave Harmonizim të saktë dhe të qartë të shënimeve për të hyrat e mbledhura midis Sektorit të financave dhe Sektorit të Shëndetësisë.
11	Mos funksionimi i programit që përdoret për futjen e të dhënave të krijuara gjatë vizitave mjekësore të pacientëve, sidomos mos i programit për pjesën në të cilën regjistrohet participimi	Humbja e evidencës së participimit dhe mosigurisë së shumës së mbledhur të të hyrave.	ZRGJ rekomandon që të krijohet baza e të dhënave në të cilën komuna duhet të mbështetet për të dhënat nga participimi.
12	Mungesa e harmonizimeve midis Librave të protokollit me raportet e tjera financiare dhe bllokave të pagesave	Mos harmonizimi i Librave të protokollit, kuponëve dhe raporteve të tjera financiare e bënë të pamundur dhënien e informatave të sakta.	ZRGJ rekomandon që të ndërmerren veprime për harmonizimin e Librave të protokollit, kuponëve dhe raporteve tjera financiare.
13	Mungesë e trajnimeve dhe pajisjeve të punës për stafin e financave.	Stafi i pamundë për punët që kryen dhe për ndryshimet që evoluojnë gjatë periudhës ndikon në kufizim të menaxhimit të mirë të informatave për të hyrat.	ZRGJ rekomandon që të mbahen trajnime shtesë të stafit të angazhuar në mbledhjen e të hyrave.
	Te hyrat nga licenca për lokale (leje të punës) 42,23		
14	Në baze të ekzaminimit të të hyrave për licencat e lokaleve kemi marrë informata se shuma e mbledhur për vitin 2006 ishte 6,820 euro. Sipas pasqyrave financiare të entitetit kemi vërejtur se në kodin 50200 komuna ka regjistruar shumën prej 43,239 euro kurse sipas freebalancit në kodin 50200 është shuma prej 18,536 .Kjo diferencë ka dalë si rezultat i përzjerjes së kodeve përkatësisht disa lloje të hyrave kanë përfshirë të hyrat totale në një kod.(të hyrat nga licencimi i lokaleve,zgjatje të orarit të punës)	Ky ndryshim ka dalë si rezultat se zyrtari i të hyrave nuk ka bërë harmonizime të rregullta me thesar.	ZRGJ rekomandon që të bëhen harmonizime të rregullta me thesarin në mënyrë që pasqyrat financiare të jenë sa më të besueshme dhe të pranueshme sipas SKK .

	Pasuritë		
15	Regjistrimi i pasurive dhe mjeteve themelore te prekshme nuk është bere ne përputhje te plote me Udhëzimin Administrativ Nr 2005/11 për Menaxhimin dhe regjistrimin e pasurive qeveritare. Regjistrimi i pasurive nuk i përgjigjet përshkrimit te mirëfillte te mjetit qe te munde te dallohet se për cilin mjete është fjala Ne mjete janë vendosur etiketat shume te dobëta prej letre ne te cilat shume lehte munde te fshihet numri dhe evidenca	Mos regjistrimi dhe evidenca adekuate sipas ligjit ka pasoja ne kontrollit mbi sigurinë dhe ekzistencën fizike të mjeteve themelore të prekshme	ZRGJ rekomandon qe Te behet regjistrimi duke respektuar ne plotësi Udhëzimin Administrativ Nr 2005/11. Evidenca dhe etiketat duhet te jene te qëndrueshme dhe ti përgjigjen përshkrimit adekuat te mjetit. Kjo ndihmon qe nga ky përshkrim personi zyrtar i komunës te jete ne gjendje te identifikoj mjetin sakte
16	Vlera e mjeteve e përshkuar ne regjistrim nuk i përgjigjet vlerës se vërtete te mjetit Nuk është bere kontabilizimi i mjeteve themelore Komuna nuk e dine se sa është vlera e mjeteve Ne raste te tjetërsimit te mjeteve themelore nuk dihet se sa ka qene vlera e mbetur dhe a ka pasur humbje apo fitim gjate tjetërsimit	Mungesa e një sistemi të unifikuar menaxhimi të pasurive dhe mjeteve themelore do ketë si pasojë informata jo të sakta për pasuritë e Komunës, e kjo mund të ndikoj drejtë për drejte edhe në Buxhet.	ZRGJ rekomandon qe Menaxhmenti i Komunës duhet te kujdeset qe të siguroj informata të përgjithshme për pasurinë fikse dhe kërkesat e nenit 1 të Instruksionit Administrativ 2005/11
17	Nuk ekzistojnë kartela specifike për mjetet themelore nga e cila do te konstatohej do te shihej Vlera e mjetit kostoja e përvetësimit jeta e përdorimit dhe zhvlerësimi i akumuluar dhe vlera e mbetur e mjetit ne funde te vitit	Mos specifikimi i mjeteve ne grupe nuk jep pasqyre te qartë te llojit te pasurisë dhe karakteristikave te tyre	ZRGJ rekomandon qe gjithashtu te krijohen kartela se paku për grupe te mjeteve ne te cilat do te shihej jeta e përdorimit norma e zhvlerësimit kosto e përvetësimit sasinë e tyre tjera
18	Komuna nuk e ka ber llogaritjen e amortizimit dhe vlerësimin e mjeteve themelore ne funde te vitit.	Vlera e pa sakte e bartur neper vite për shkaka te mos llogaritjes se zhvlerësimit dhe amortizimit te mjeteve themelore rezulton me vlerësimin jo real te pasurisë.	ZRGJ rekomandon qe Te përpilohet një strategji e menaxhimit te pasurive dhe te përpilohet plani i mirëmbajtjes ne përputhje Instruksioni administrative 2005/11
	Stoqet		
19	Komuna nuk ka të prezantuar në Bilancin e gjendjes të Komunës pozicionin e stoqeve. Ne kemi vërejt se stoqet të cilat Komuna i ka në depot e Mjekësisë Familjare dhe të Entit për Ndihmë të Shpejtë Mjekësore, si dhe në depot nëpër çerdhe të fëmijëve, shkolla, bufe etj. Ndërsa në ekzaminimin e depove në Mjekësi Familjare dhe Entin për Ndihmë të Shpejtë Mjekësore, ne konstatuam se aty ka pasur barna dhe mallra të tjera më 31.12.2006, të cilat ishin të regjistruara(inventarizuara) por që nuk ishte bërë asnjë barazim i	Mos prezantimi i një vlere te konsiderueshme te stoqeve ne pasqyrat financiare rezulton me raportim jo te drejte te pasurisë se komunës Rreziku i humbjes se mallrave t e ndryshme ne mungese se evidencës se mirëfilltë .	ZRGJ rekomandon qe te mbahet evidence e mirëfillte e stoqeve. Te përcillet bartja e tyre nga viti i mëparshëm dhe te behet rifreskimi i te dhënave ne mënyrë permanente Ne funde kjo vlere te paraqitet ne pasqyrat financiare ne Bilancin e Gjendjes Te evidentohen dhe shpalosen barnat qe

	tyre. Stoqet ne shtëpinë e shëndetit ishin te mbajtura ne evidencat e exell-it ne mënyrë te gabuar ,nga te dhënat qe i morëm shihet se ne evidence ma tepër janë dhëne barna se sa qe janë pranuar me mija copa. Ne njërën nga depot e vjetra mbaheshin një mase e madhe e barnave te ndryshme te cilave u kishte kaluar afati i përdorimit Nuk kishte asnjë evidence ne te cilën munde te konstatohej se çfarë barnash janë këto dhe sa është vlere e tyre Sidoqoftë këto materiale si pas punëtores ishin rrezik për ambientin e afërt		ju ka skaduar afati dhe te largohen sa ma shpejte nga ambienti i cili frekuentohet nga popullata.
	Shfrytëzimi i Pasurive – Autoparkut		
20	Komuna nuk ka Politika për shfrytëzimin e Automjeteve Automjetet janë shpërndare neper departamente ne kompetence te drejtove Përgjegjësi i autoparkut nuk disponon një plan për përdorimin e automjeteve të autoparkut të Komunës, kështu që kërkesat tek ai arrijnë prej rasti në rast. Po ashtu nuk ekziston një normativ i lejuar i shpenzimeve për vetura zyrtare, prandaj ato pranohen si të tilla për aq sa janë paraqitur Komuna nuk e dine se sa i ka borxh pompës furnizuese për automjete sepse nuk mbahet evidence e shpenzimeve nga ana e komunës Gjithashtu nuk ka ndonjë mbikëqyrje e shfrytëzimit të automjeteve. Nuk mbahet evidence për gjendjen teknike te automjeteve	Moskthimi i automjeteve zyrtare në parkingjet e automjeteve të komunës krijon mundësin e shfrytëzimit të automjeteve për qëllime private, rritjen e shpenzimeve të karburanteve,ekspozimin e rrezikut për prishje,vjedhje etj. Një praktikë e mosbarazimeve të shpenzimeve dhe kilometrave të kaluara, dhe kur nuk dihet destinimi i shfrytëzimit të tyre krijon mundësin të bëhen shpenzime pa kriter te karburanteve dhe riparime fiktive.	ZRGJ rekomandon qe te përpilohet politikat te shkruara ne përputhje me ligjet ekzistuese ne Kosove dhe te krijohet sistemi i kontrollit për përdorimin e automjeteve ZAGJ rekomandon Menaxhmentit të Komunës që të hartojë Politika për përdorimin e automjeteve zyrtare. Poashtu te mbahet evidence për çdo riparim dhe përdorime te automjeteve ne nivel te një kriteri te njëjtë për te gjithë përdoruesit e automjeteve
	Pagat dhe mëditjet		
21	Gjatë ekzaminimeve te dokumentacionit te dosjeve te personelit ne shumicën e rasteve kishte kontrata te pa nënshkruara Shuma e pagave ne kontrate nuk ishte e njëjtë me shumën ne listën e pagave Ne gjithashtu gjetëm se ne dosje nuk ekziston vendimi për rritjen e pagave ne disa raste nuk kishte asnjë vlerësim paraprak për avancime. Ne dosje ekzistojnë vendimin për pranim dhe vendimet për pushime vjetore, ndërsa mungojnë të dhënat tjera, si kualifikimi, trajnimet, verifikimet, dënimet, avancimet etj. Tek dosjet e personave me përgjegjësi të veçanta (në pozitat	Regjistrat e personelit nuk do të jenë efektivë për të përkrahur të dhënat e dosjes kryesore të listës së pagave apo për të ofruar dëshmi efektive për të përkrahur mosmarrëveshjet e mundshme të punë marrësit. Ekziston rreziku i shtuar i pagesave jo korrekte apo pagesave që vazhdojnë t’u paguhen ish- të punësuarve.	ZRGJ rekomandon qe Regjistrimet e personelit të punëmarrësve duhet të azhurnohen për të gjitha ndryshimet eventuale, si dhe kohë pas kohe të zbatohen procedurat e kontrollit mbi plotshmërinë përmbajtësore të dosjeve të punësuarve. Te ripërtërihen kontratat e reja me kohe për çdo ndryshim eventual me paga Të zbatohen procedurat për përshtatshmëri të bazuara në Ligjin mbi

	zgjedhëse) nuk ekzistojnë dëshmi mbi zbatimin e procedurave për përshtateshmëri të kërkuara në bazë të nenit 12 të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike.		Menaxhimin e Financave Publike.
	Mallra, shërbime dhe Investime kapitale		
22	Në dy raste: - Furnizim me material zyre dhe - Furnizim me dhurata Zotimi i mjeteve është bërë me vonesë	Mos zotimi i mjeteve para se të iniciohen procedurat e prokurimit mund të shpie të hyrja në obligime nga ana e Komunës, por edhe në ndryshim të destinimit të mjeteve nga një projekt në tjetrin.	ZRGJ rekomandon që zotimi i mjeteve duhet të bëhet gjithnjë para se të fillojnë procedurat e prokurimit
23	Në 3 (tri) mostra: - Furnizim me material zyre - Rrethimi i varrezave ortodokse dhe - Furnizim me derivate të naftës. Në fletë porosi zyrtar pranues ka qenë zyrtari i prokurimit.	Kjo ndikon në ndarje të dobët të detyrave, midis blerjes dhe pranimi të mallit. Pranimi I mallit nga ana e zyrtarit të prokurimit, I cili ka cilësinë e blerësit shkakton përzierje të detyrave.	ZRGJ rekomandon që të respektohet në përpikëri ndarja e detyrave. Te evitohet pjesëmarrja me nënshkrim të zyrtarit të prokurimit në Fletë porosi.
	<i>Furnizim me material zyre në vlerë prej: 14,719.00</i>		
24	Në kontratë nuk është përcaktuar afati i kohëzgjatjes edhe pse kontrata ka qenë afatgjatë.	Mos përcaktimi i kohëzgjatjes së kontratës mund të shpijë të menaxhimi i afatit të kësaj kontrate sipas dëshirës e jo sipas kushteve të parapara	ZRGJ rekomandon që Komuna për cilëndo kontratë apo projekt të zhvilluar duhet të caktoj periudhën e kohëzgjatjes së kontratës
25	Janë blerë materiale, si Ditar klase, Libra etj në vlerë; 6,014 Euro nga Operatori ekonomik që ka furnizuar komunën gjatë vitit 2006. Këta artikuj nuk kanë qenë të parapara fare në kontratë dhe specifikacion teknik.	Dobësitë në mos përfshirjen e mallrave në specifikacion teknik dhe në kontratë mund të shkaktojnë fyerje të çmimeve në rast të blerjeve.	ZRGJ rekomandon që Autoriteti kontraktues domosdoshmërisht kërkohet që çdo artikull që do të blej ta përfshijë në specifikim teknik dhe kontratë, me qëllim që çmimet për këto artikuj të jenë të ofruar përmes konkurrencës së plotë dhe transparente.
26	Nuk janë hartuar raporte të pranimi të mallrave.	Mungesa e raporteve të pranimi të mallrave bie në kundërshtim me praktikën e kontrollit të brendshëm. Me këtë rast Komuna nuk shpalos në detaje dhe nuk siguron se malli i pranuar është ai që është porositur.	ZRGJ rekomandon që Komuna duhet të zhvillojë procedurë përkatëse për pranimin e mallrave në mënyrë që të sigurojë se çdo mall i blerë është pranuar në sasi dhe cilësi të kërkuar.
	Rrethimi i Varrezave Ortodokse në Rahovec, vlera; 15,998.70		
27	Mungon nënshkrimi i njërit nga anëtarët e komisionit vlerësues në dy dokumente të procesit të vlerësimit.	Mungesa e nënshkrimit nga anëtarë i komisionit vlerësues të ofertave krijon mos besueshmëri në procesin e vlerësimit të ofertave.	ZRGJ rekomandon që çdo dokument zyrtar i cili përgatitet nga komisioni vlerësues duhet të nënshkruhet ose duhet të lihen arsye për tërheqjen e nënshkrimit të tij /saj.

28	Mbikëqyrësi i punimeve është njëkohësisht anëtar i komisionit vlerësues të ofertave	Pjesëmarrja e Mbikëqyrësit të punimeve në vlerësimin e ofertave mund të sjellë të ndikimi i tij në Objektivitetin e vlerësimit të ofertave. Kontroll i dobët i brendshëm.	ZRGJ rekomandon që të forcohet kontrolli i brendshëm në mënyrë që të evitohen mundësitë e pjesëmarrjes së zyrtarëve në dy apo me shumë detyra të ndërlidhura me njëra tjetrën.
29	Mungon procesverbali i vlerësimit të ofertave ku shpjegohen arsyet e qarta të eliminimit nga konkurrenca e ofertës me të lirë.	Mungesa e dëshmive të procesit të vlerësimit të ofertave dhe mos shpjegimi i arsyeve për eliminimin e ofertës më të lirë është devijim i Nenit 29.13 e Rregullores së Prokurimit Publik, pjesa B.	ZRGJ rekomandon që duhet të përgatiten procesverbalet e vlerësimit që përmbajnë shqyrtimet dhe vlerësimet e procedurës së ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.
30	Mungon vendimi për caktimin e komisioneve të hapjes dhe vlerësimit të ofertave.	Mungesa e vendimeve të tilla është dëshmi e mungesës së Kontrollit të brendshëm nga ana e Departamentit të Prokurimit.	ZRGJ rekomandon që në të ardhmen komuna duhet të nxjerr vendime me shkrim në rastin e autorizimit të personave për vlerësimin dhe hapjen e ofertave.
31	Mungon vendimi për caktimin e Menaxherit të kontratës, (Mbikëqyrësit të punëve).	Mungesa e vendimit është dëshmi e mungesës së Kontrollit të brendshëm nga ana e nivelit menaxherial.	ZRGJ rekomandon që për shkak të rëndësisë që ka mbikëqyrja e kontratës, Komuna duhet të lenë dëshmi me shkrim se ka caktuar personin apo personat për menaxhimin e kontratës.
	<i>Furnizim me Derivate të Naftës; 74,000€</i>		
32	Mungon analitika e evidencave të pranimit të derivateve, pas furnizimit,. Gjithashtu nuk ka ndonjë procesverbal të pranimit dhe kontrollit të cilësisë dhe sasisë së naftës.	Mungesa e evidencave analitike dhe e dokumenteve mbështetëse (procesverbaleve) të pranimit dhe kontrollit të sasisë dhe cilësisë tregon për menaxhim jo të mirë të krijimit të sigurisë së artikullit në fjalë është shfrytëzuar si duhet.	ZRGJ rekomandon që me rastin e shpenzimit të naftës të lihen me shumë dëshmi mbi mënyrën e shpenzimeve, sasinë dhe cilësinë e naftës së pranuar.
33	Nuk ka një përshkrim të aftësive profesionale të anëtarëve të komisionit vlerësues të ofertave	Mos përshkrimi i aftësive apo edhe mos pjesëmarrja e ndonjërit nga anëtarët si njohës profesional i artikullit që do të blihet mund të shkaktoj përzgjedhje të ofertës me artikull jo cilësor.	ZRGJ rekomandon që në përbërje të komisionit vlerësues të ofertave duhet të caktohet se paku ndonjë anëtar që është njohës i fushës apo artikullit i cili bekohet të blihet
34	Në shkollat e komunës, pranimi i naftës është bërë vetëm nga ana e përgjegjësve të shkollave. Nuk është bërë edhe nga zyrtari pranues i mallit apo ndonjë komisioni i posaçëm.	Pranimi i mallit vetëm nga Drejtori i shkollës e jo edhe nga personi kompetent komunal sipas kërkesave të rregullave është anashkalim i procedurave zyrtare dhe praktikave me të mira të mundshme.	ZRGJ rekomandon që cdo mall i blerë duhet të pranohet përmes zyrtarit të pranimit të mallit.

35	Komuna nuk ka lënë dëshmi se ka vërtetuar se është bere ngritja e çmimeve te naftës ne BERZE dhe me pas e ka aprovuar ngritjen e çmimit të naftës të përcaktuar në kontratën e datës 05.09.2006	Mos lënia e dëshmive se komuna paraprkisht ka vërtetuar kërkesën e kompanisë për ngritje te derivateve te naftës ne BERZE bën qe ngritja e çmimit te mos jete e besueshme.	ZRGJ rekomandon qe në raste te tilla komuna duhet të vërtetoj saktësisht ngritjen e çmimit, te përgatis dëshminë me shkrim për këtë si dhe të le dëshmi të tjera te argumentuara.
36	Mungon autorizim me shkrim nga autorizuesi për iniciimin e procedurave të prokurimit	Mungesa e autorizimit me shkrim për iniciimin e procedurave të prokurimit është në kundërshtim me Nenin 20.1 të Ligjit të Prokurimit Publik të Kosovës	ZRGJ rekomandon qe asnjë aktivitet i prokurimit nuk duhet të fillohet para se zyrtari autorizues i komunës të vlerësoj dhe aprovoj nevojën për fillim te procedurave te prokurimit.
37	Urdhër blerjen në pozicionin e nëpunësit pranues të mallit e nënshkruan zyrtari i prokurimit .Njëherë ai është edhe anëtar i komisionit vlerësues të ofertave.	Ngarkesa e zyrtarit me shume funksione (punë dhe detyra të cilat janë të ndërlidhura njëra me tjetrën)është në kundërshtim me procedurat dhe praktikrat e Kontrollit te brendshëm. Kjo mund të krijoj formë të monopolit në kryerje te procedurave.	ZRGJ rekomandon qe të bëhet shpërndarje e drejtë dhe e organizuar e detyrave.
38	Mungojnë vendime për themelimin e komisioneve të hapjes dhe vlerësimit të ofertave.	Mungesa e vendimeve të tilla është dëshmi e mungesës se Kontrollit të brendshëm nga ana e niveleve menaxherive	ZRGJ rekomandon qe ne te ardhmen komuna duhet te nxjerr vendime me shkrim ne rastin e autorizimit të personave për vlerësimin dhe hapjen e ofertave.
39	Urdhër blerja është aprovuar nga zyrtari aprovues, jo zyrtari i prokurimit, siç parashihet me Ligjin e prokurimit publik 2003/17	Aprovimi i Urdhër blerje nga zyrtari autorizues është në kundërshtim praktikrat dhe procedurat qe aplikon Thesari. Menaxheri i prokurimit është personi përgjegjës qe bën aprovimin e blerjeve.	ZRGJ rekomandon qe Urdhër blerja duhet të nënshkruhet nga Menaxheri i prokurimit.
	Furnizim me dhurata, vlera; 7,668 €		
40	Vlerësuesit e ofertave nuk kanë lënë kurrfarë dëshmie mbi arsyeshmërinë dhe kriteret qe kanë zbatuar për përcaktimin e Ofertës fituese, pasi qe 3 ofertat e pranuar kanë qenë me çmim të njëjtë prej; 6,600 euro.	Mos lënia e dëshmive për arsyeshmerinë e përzgjedhjes se ofertës fituese si dhe mos aplikimi i kriterëve në mënyrë të drejtë, kur kihet parasysh se tre ofertat kanë qenë me çmime të njëjta është në kundërshtim me Nenet. 50.1, 50.2 dhe 58.2. të LPP	ZRGJ rekomandon qe në rast kur të gjithë operatorët ekonomik ofertojnë me çmime të njëjta Komuna është e obliguar të vlerësoj në përputhje me rregullat e përcaktuara me LPP dhe të jap arsyeshmëri të plotë për përzgjedhjen e Operatorit fitues.
41	Ne specifikimin teknik të Dosjes se Tenderit, të cilin ia ka ofruar Operatorëve ekonomik komuna vet ka përcaktuar vlerën në euro të mallit të kërkuar .Ref. (specifikimi teknik).	Çmimi i vendosur në Specifikim teknik dhe Dosje te Tenderëve, edhe nëse është lëshim teknik tregon për jo disiplinë dhe pakujdesi në përgatitje të dokumenteve.	ZRGJ rekomandon qe Komuna nuk duhet të caktoj çmimet me rastin e kërkesave për ofertim.

42	Dy nga tri ofertat e pranuar nuk kanë qenë të përgjegjshme nga ana administrative. Nuk ishin as të nënshkruara dhe as të vulosura. Gjithashtu u mungonin edhe certifikatat e biznesit, të cilat ishin kërkuar me dosje te tenderit. Ref (Oferta "Albin" dhe "Hysen Trade").	Përzgjedhja e Operatorit ekonomik, kur dy nga tri ofertat kanë qenë të pa përgjegjshme është në kundërshtim me nenin 30.3 të LPP-së.	ZRGJ rekomandon qe në rast kur komuna pranon oferta të pa përgjegjshme është e obliguar të anulojë atë prokurim dhe të vazhdoj me përsëritje të prokurimit të ri.
	<i>Ndërtimi i kanalizimit të Ambulancës në Krushë te madhe, vlera; 498 €</i>		
43	Nuk është bërë kurrfarë raporti i pranimi të punimeve.	Mungesa e raportit te punimeve të kryera pamundëson krijimin e sigurisë se kualiteti dhe kuantiteti i punëve të parapara është kryer i plotë.	ZRGJ rekomandon qe Komuna të siguroj raporte të sakta dhe në kohë për punët e kryera.
44	Njëra nga ofertat nuk është e përgjegjshme. Është bërë nga kompani hoteliere, ndërsa punët janë të fushës se ndërtimit të ulët.	Vlerësuesit e ofertave në këtë rast kanë demonstruar jo profesionalizëm në vlerësim. Pranimi dhe futja në konkurrencë e kompanive të pa përgjegjshme bie në kundërshtim me nenin 30.3 të LPP-së.	ZRGJ rekomandon qe Komuna nuk duhet të pranoj Oferta të Operatorëve ekonomik, të cilat nuk mund të kryejnë aktivitetet qe kërkohen.
	Auditimi i shpenzimeve tjera		
45	<i>Ndërtimi I Kulmit të Shkollës në Nagavc, vlera; 30.000 €</i>		
	Përshkrimi I Urdhërpaguesës nuk është në harmoni me pozicionet dhe situacionin që është paguar. Janë zotu dhe janë paguar mjetet në emër të ndërtimit të kulmit, ndërsa situacioni dhe fatura kanë qenë me pozicione të punëve të tjera të kësaj shkolle.	Kjo tregon për ndryshim të destinimit të mjeteve. Ky ndryshim reflekton me mos zbatim të planifikimit buxhetor në linja dhe kategori të parapara.	ZRGJ rekomandon qe Zyrtarët komunal duhet të bëjnë përshkrime të sakta të pagesave si dhe të evitohen ndryshimet e destinimit te mjeteve nga ato te planifikuara ne ato te shpenzuara
46	<i>Ndërtimi i Shkollës se mesme në Ratkovc, vlera; 497,550 €</i>		
47	Komuna nuk ka bërë rishikimin dhe vlerësimin e projektit të cilin ia ka sjellë komuniteti i fshatit para se te iniciojë procedurat e prokurimit. Si pasojë e sajë kanë ndodhur shpenzime të pa parashikuara. Vlerën e shpenzimeve te paguara për punën e bere pa nevojë komuna nuk ka arritur te na saktësoj. Ky projekt është rishikuar pasi qe janë paraqitur këto probleme	Mos vlerësimi dhe mos rishikimi I projektit te cilin komuna e ka marrë falas nga komuniteti i fshatit ka sjellë deri te fillimi i punimeve në vend të gabueshëm. Kjo ka sjellë dëmtim të buxhetit, zvarritje të punimeve etj.	ZRGJ rekomandon qe Komuna nuk duhet të lejoj të fillojnë procedura te prokurimit pa i bërë paraprakisht të gjitha analizat e projektit, dhe pa bërë vlerësimin e terrenit.
48	Është paguar paradhënie dhe nuk është kërkuar Sigurimi i Avansit.	Pagesa e paradhënies pa bërë paraprakisht sigurimin e atyre mjeteve qe do te jepen krijon rrezik te madh për humbje te mundshme te atyre mjeteve.	ZRGJ rekomandon qe në çdo ratë të pagesës se paradhënies komuna duhet të siguroj paraprakisht ato mjete, përmes sigurimit bankar te avansit.
49	Në emër të avansit është paguar situacion i pa kryer deri atëherë në vlerë: 50,000 euro. Dëshmitë e komunës tregojnë se për këtë vlerë të mjeteve është punuar vetëm 3 ditë. Puna ka filluar me	Pagesa e shpenzimeve në vlerë prej; 50.000 euro për një periudhe kaq të shkurtër kohore prej 3 ditësh mund të nënkuptohet si mos paraqitje të gjendjes	ZRGJ rekomandon qe Komuna duhet të përcjell dhe paraqes shënime reale për punë të kryera.

	date 02.12.2005, ndërsa pagesa është bërë me 07.12.2005.	reale dhe kryerje e pagesave pa u kryer punët edhe pse ekziston Situacion i punimeve.	
50	Nuk është bërë paraprakisht kurrfarë paralogarie, Nuk janë zhvilluar negociata lidhur me kushtet dhe çmimet e punëve shtesë të paraqitur. Nuk është bere aneks marrëveshje si dhe nuk është siguruar kurrfarë aprovimi nga Agjensioni i Prokurimit Publik për punën shtesë.	Mungesa e këtyre hapave ka mundur të monopolizojë vënien e çmimeve për pozicione të cilat nuk kanë qenë të parapara me kohë. Kjo është në kundërshtim me Nenin 8.1; 34.1; 34.2-d; 34.3; 34.4 të LPP-së.	ZRGJ rekomandon qe Të respektohen në përpikëri rregullat e parapara me Ligj.
51	Janë bërë ndryshime në pozicione dhe nuk janë dhënë arsyetime. Gjithashtu nuk ekziston kurrfarë kërkesë për bërjen e ndryshimeve në fjalë. (Është bërë ndryshimi I mbulesës se kulmit. Me kontratë është paraparë qe të mbulesa të jetë me Lllamarinë, ndërsa ne vende te saje janë përdor tjegulla.	Mungesa e dëshmimeve qe do të bënin të arsyeshëm ndryshimet në pozicione dhe mungesa e kërkesave për bërje të ndryshimeve tregon për kontroll të brendshëm të dobët. Kjo gjithashtu ndikon në krijimin e pasigurisë se malli i përdorur ka vlerën dhe kualitetin e parasë se dhënë	ZRGJ rekomandon qe Komuna duhet të siguroj se të gjitha ndryshimet e bëra kanë qenë në dobi të kualitetit të projektit dhe në kundërvlerë të parasë se dhënë.
52	Punimet janë kryer shume kohe me vone se afati i përcaktuar	Mosrespektimi i afatit kohor të paraparë sipas planit dinamik të ofertës fituese drejton në mosrespektim të kërkesave të kontratës si dhe dëmtim të konkurrencës, transparencës dhe buxhetit komunal.	ZRGJ rekomandon qe Menaxhmenti i Departamentit të Prokurimit të angazhohet që të respektohen me përpikëri kushtet e kontratave të nënshkruara nga OE. Për arsyet e mosrespektimit të lihen dëshmi në dosje. Nëse arsyet janë të paqëndrueshme të zbatohen penalet sipas kërkesave të rregullave.
53	Janë pranuar punë të cilat, në realitet nuk janë kryer kurrë. Është përgatit dhe nënshkrua nga zyrtarët komunal situacion i kryerjes se punimeve shtesë në vlerë prej; 71,541 euro (asfaltim dhe pune te tjera). Konstatimi i auditorit, ne baze te një raporti te kërkuar ne kohen kur kemi audituar është se pune te kryera janë vetëm; 25.121 euro.	Dukuri të tilla te shpien të papërgjegjësia administrative e zyrtarëve dhe tregojnë se mbikëqyrja dhe kontrolli I punimeve nuk është bërë as në masë minimale. Kjo gjithashtu le te kuptohet si tendencë e pagesës se parave para se te kryhen punimet.	ZRGJ rekomandon qe Komuna duhet të nxjerr një raport me shkrim dhe të sqaroj saktësisht të gjitha aktivitetet e bëra në lidhje me këtë rast. Të siguroj gjithashtu mbikëqyrje të rregullt dhe të saktë të projekteve duke i dëshmuar me shkrim çdo punë të kryer
54	Nuk është nënshkruar raporti i pranimit teknik të punimeve nga ana e njerit nga anëtarët e komisionit pranues-përfaqësues nga komuna, si dhe nga dy anëtarë të tjerë -përfaqësues nga CIMIC-u gjerman i KFOR-it. (KFOR-i gjerman ka participuar me 120,000 euro ne këtë projekt). Ne bisede me ta, ata kane deklaruar se nuk kane qene te kënaqur me kualitetin e punës se kryer. KFORI-gjerman për defektet ne Objekt ka lënë edhe një procesverbal, kopjen e te cilit e kemi ne dosje.	Mos nënshkrimi i anëtarëve të komisionit teknik të pranimit të punimeve dëshmon se punimet e parapara me kontratë nuk janë kryer sipas kualitetit të përcaktuar. Efekti i mos përmbushjes se kualitetit të paraparë me kontratë është dëmtim i buxhetit.	ZRGJ rekomandon qe Komuna duhet të ndërmarr masa për konstatimin e kualitetit të punëve të kryera, dhe të evitoj defektet e ndodhura.

	Lidhja e kontratës pa zotim të mjeteve Kërkesa për caktimin e lokacionit pas 4 muaj nga firma fituese Ndryshimet e bëra në paramas Kërkesa për sigurimin e ekzekutimit prej 15,000 euro në Bankën e Re me e vogël se sa kërkon LPP prej 10% nga vlera e kontratës Zotimi i mjeteve dhe pagesa prej 42,977 bëhet në emër të asfaltimit të oborrit të shkollës ndërsa në fakt është kryer pagesa për situacionin e 6-të (punët e qeramikës, molerimi etj.)	Hyrja e entitetit në obligime pa zotim të mjeteve përmban një rrezik se obligimet nuk mund të mbulohen në të ardhmen. Kërkesa shume e vonshme për fillimin e punëve le të dyshohet se kjo firme ka fituar punën pa bere incizimin e vendit ku do të filloj punën, Mos rishikimi i projektit nga entiteti me kohe ka pasur si rrjedhojë edhe ndryshimet në paramasën, Meqenëse mungon raporti me shkrim se çfarë është punuar është mjaft e paqarte se a janë kryer këto pune për të cilat janë dhënë mjetet nga KFORI Gjerman Është shkëlur neni 60.4 LPP 2003/17 Zotimi dhe pagesa nuk është bërë sipas dinamikës së punëve të kryera, por këtë pagesë e ka bërë për një pune e cila nuk është kryer fare.	ZRGJ rekomandon që të mos fillohet asnjë procedure e prokurimit pa zotim paraprak të mjeteve, sepse një forme e tillë mund të shkaktoj probleme të panevojshme. Te merren vendime me kohe për çdo projekt e jo të filloj puna dhe të bëhen shpenzime të dyfishta. Te përpilohen projektet në mënyrë profesionale nga personat përkatës me profesione përkatëse. Menaxheri i projektit duhet të dorëzoj në çdo kohe raportet për punët të cilat janë kryer dhe në këtë rast për situacionet e kryera. Të respektohen rregullat që dalin nga LPP nr.2003/17. Të mos zotohen dhe paguhen punët të cilat nuk janë kryer.
55	Paraja e imte Pas rishikimit të zbatimit të procedurave për shpenzimin e parasë se imtë dhe pas testimit të mostrave nuk kemi gjetur ndonjë parregullsi të rëndësishme.	Drejtnesit financiar kanë zbatuar kërkesat e rregullave në praktikë	ZRGJ inkurajon drejtnesit financiar që edhe në të ardhmen të angazhohen që kërkesat e rregullave ti zbatojnë në praktikë
56	Rregullim (pastrimi) i Lumit në Bellacerk (Fortesë) 7,158 Shpallja e tenderit pa zotim të mjeteve (Nr.kontrates 62306011536) Mungon dokumenti për TVSH Komisioni për vlerësim dhe pranim teknik me dy anëtare të njëjtë	Shpallja e tenderit pa zotim të mjeteve paraqet shkelje të procedurave lidhur me menaxhimin e parasë publike si dhe përmban një rrezik për mos përmbushjen e obligimeve Pagesat e kryera me TVSH ndonëse nuk hasen në dokumentin për TVSH ,mund të ketë pasoj që operatori të mos jetë i regjistruar si subjekt i TVSh-së. Komision për vlerësim dhe pranim teknik me anëtare të njëjtë mund të ketë konflikt interesi.	ZRGJ rekomandon që të mos të iniciohet asnjë aktivitet i prokurimit pa pasur mjete të zotuara. Mos të kërkohet pagesa e TVSH-së nëse nuk është kërkuar në dokumentin standard. Mos të marrin pjesë personat e njëjtë në komision për vlerësim dhe pranim teknik të punëve
57	Ndërtimi I aneksit të çerdhës së fëmijëve në "Tulipanët" 24,990 Mungon data mbi raportin ekzekutimit të punëve nga mbikëqyrësi i projektit .	Mungesa e datës në raportin e menaxherit të projektit ka si pasojë e mos përcjelljes së punëve në teren nga mbikëqyrësi Shkelje e kushteve të parapara me dokumentin	ZRGJ rekomandon që të përcillen punët në teren dhe në rast të përkrahimit të punëve të përkrahur puna ashtu siç janë kryer nga operatori.

	Garancioni për përmbushjen e detyrimeve nga firma'' Ndërtimi' nuk I përgjigjet kushteve të kontratës sepse garancioni I lëshuar ka pasur një vlefshmëri deri me datën 01.02.2005 e jo vlefshmëri 3 muaj pas pranimi teknik të punëve	standard lidhur me sigurimin e garancionit bankar (pika 27.0 e dosjes se tenderit)	Ne te ardhmen te respektohen te gjitha kushtet qe dalin nga dokumentet e kërkuara ne dosjen e tenderit.
58	Furnizim dhe shtruarja e rrugës me zhavorr Komisioni për hapje dhe vlerësim I njëjtë Faturat të cilat janë paguar nuk janë nënshkruar Nuk janë realizuar punët të cilat janë kërkuar në specifikacionin teknik	Përbërja e njëjte ne komision për hapje dhe vlerësim si dhe pranim teknik mund te ketë rrezik te përfitimeve individuale, Është rrezik që të paguhet fatura fiktive nëse nuk nënshkruhet fatura nga zyrtari përgjegjës, Në specifikacionin teknik është kërkuar te behet furnizimi dhe shtruarja me zhavorr te rrugës ne disa fshatra,por kjo ishte bere vetëm ne 6 prej tyre gjë qe paraqet konfuzion te ofertuesit	ZRGJ rekomandon qe të formohen komisione të ndryshme për hapje dhe vlerësim ne mënyre qe te shmanget dyshimi për konflikt interesi. Po ashtu te mos behet pagesa pa u nënshkruar fatura e pranuar nga zyrtari përgjegjës. Të mos shpallet tenderi si dhe te mos përpilohet specifikacione për kryerjen e punëve për te cilat pune nuk ka mjete te mjaftueshme.
59	Riparim dhe Mirëmbajtje te Automjeteve te komunës 24,042 Shpallja e tenderit pa zotim te mjeteve Nuk ka kërkesë për riparimin e automjeteve Ka servisime te cilat nuk janë prezantuar ne oferte	Shpallja e tenderit pa zotim te mjeteve mund te ketë si pasoje e mos përmbushjes se obligimeve me kohe Mungesa e kërkesave për riparimin e automjeteve nuk është praktike e mire dhe një gjë e tille le te dyshohet se është bere apo nuk është bere servisi I automjetit te Komunës.. Servisi për ato pjese te cilat nuk janë paraqitur ne oferte ka si rezultat mundësin pagesës me çmim me te larte se sa çmimet e tregut.	ZRGJ rekomandon qe te mos shpallet tenderi pa pasur mjete te zotuar Për çdo servisim te automjeteve te paraprij kërkesa për riparim Te përpilohet lista për koutim te çmimeve ne mënyre qe te mbuloj te gjitha nevoja e mundshme për riparimin e mjeteve
60	Anulim i Projektit (furnizim me karte vizita) 120 € Nuk është kryer ky projekte ngase entiteti nuk rishikon disponueshmerin e mjeteve financiare	Nuk janë kryer aktivitet e prokurimit si pasoj e mungese se mjeteve	ZRGJ rekomandon qe te rishikohen mundësit financiare para se te behet inicimi I ndonjë aktiviteti te prokurimit.
61	Vendosja e kanalizimit – shëndetësi 498 € nuk ka raport për pranim teknik te punëve	Mungesa e dëshmive(procesverbalit)për punën e kryer mund te ketë rrezik për mos kryerjen e punëve ashtu siç është kërkuara.	ZRGJ rekomandon qe sipas procedurës për çdo pune te kryer te behet pranimi teknik i punëve
62.	Shpenzimet tjera (dreka zyrtare) 2,313.20 Faturat e muajit Maj,2005 janë paguar ne Maj te vitit 2006 Faturat janë ne shume absolute duke mos prezantuar(specifikuar) se çka kane furnizuar sa pije,ushqim etj.	Pagesa e faturave te vitit 2005 ka si pasoje e zvogëlimit te buxhetit te vitit 2006 Përshkrimi se çfarë është furnizuar ka si rrezik që dalja e parasë të mos jetë e justifikueshme.	ZRGJ rekomandon qe te behet pagesa ne kohë, ne mënyre qe mos te lihet dyshimi për pagesa te dyfishta. Çdo fature e cila paguhet te ketë edhe një dokument mbështetës e cila arsyeton shpenzimin.

Aneksi 2 Komentet e komunës se Rahovecit

	Komentet e Komunës	Veprimet plotësuese te komunës	Komentet e Auditorit
1	Rekomandimi pranohet për këtë vit. Ne vitin 2007 është eliminua kjo parregullsi,mjetet tani derdhen në xhirollogarinë e komunës dhe përcillen nga ZF i DKA-së.	Në vitin 2007 është eliminuar., pas marrjes së rekomandimit nga auditimi i vitit 2005.	Mbesin konstatimet e auditorit. Vlerësojmë gatishmërinë tuaj për implementimin e rekomandimeve tona.
2	Pranohet rekomandimi pjesërisht vetëm për RDPP.	Do të eliminohet gjatë periudhës në vijim.	Mbesin konstatimet e auditorit. ZRGJ rekomandon që komuna të kujdeset që të ketë evidenca të sakta, komplete dhe gjithëpërfshirëse për lëndët e proceduara.
3	Pranohet rekomandimi se gjatë vitit 2006 fillimisht inkasomi i të hyrave të pronave të paluajtshme është bërë vetëm në bazë të rregullores komunale kurse Udhëzimi administrativ i AKK-së 2006/1 ka filluar të implementohet pas tremujorit të parë të këtij viti (2006). Nga prilli i vitit 2006 deri në shtator të vitit 2007 inkasimi është bërë edhe në bazë të rregullores komunale dhe udhëzimit administrativ 2006/1.	Në vitin 2007 pas vërejtjes që na është bërë me rastin e certifikimit të rregullores nga Komisioni i MEF-it dhe MAPL-së tani aplikohet vetëm tarifa e paraparë me Udhëzimin Administrativ 2006/1 i nënshkruar nga AKK.	Mbesin konstatimet e auditorit. Vlerësojmë gatishmërinë tuaj për implementimin e rekomandimeve tona
4	Pranohet rekomandimi, zyrtari komunal ka llogaritur gabimisht edhe pjesën e paluajtshmërisë e cila është pronë e KK. Pagesa është dashur të bëhet vetëm për pjesën e pronës private dhe atë jo në vlerë prej 20 por 50 euro sipas nenit 8 të udhëzimit administrativ 2006/1 të AKK.	Në të ardhmen zyrtarët përgjegjës gjatë përllogaritjes së tarifës për palët në procedurë.	Mbesin konstatimet e auditorit. Vlerësojmë gatishmërinë tuaj për implementimin e rekomandimeve tona
5	Rekomandimi i auditorit në mostrën nr. 12 nr.215/1 të datës 09.10.2006 dhënia e lejes së ndërtimit , kalkulimi i vlerës për pagesë është Llogaritur në bazë të Rregullores Komunale për Tarifa dhe Ngarkesa të datës 07.03.2006, e cila parasheh për pikën 8, pagesa në nën kulm dhe podrum është 40% dhe në pikën 9 për ndërtim në themele ekzistuese 40% e tarifës komunale. Drejtoria rekomandimin e Auditorit gjeneral e kupton si brengë të arsyeshme mirëpo llogaritja e tarifës është bërë duke u bazuar në rregulloren dhe formulimi i tekstit të tarifës i cili është kuptuar nga stafi i kësaj drejtorie.	I rekomandohet drejtorisë për Urbanizëm që për vitet në vijim të përcakton në mënyrë të saktë tarifat për pozicionet e veçanta me qëllim të evitimit të gabimeve eventuale.	Mbesin konstatimet e auditorit. ZRGJ rekomandon qe Menaxhmenti të kryej kontrollin e duhur për aplikimin e Rregulloreve te aplikueshme drejtë dhe saktë.
6	Rekomandimi në këtë pikë janë pjesërisht të pranueshme. Sqarim:Objektet të cilat Komuna i ka dhënë në shfrytëzim janë në dy forma . 1 .Lokalet në objektet të cilat kanë qenë në gjendje për shfrytëzim d.m.th të gatshme pa nevojë investimi janë të dhëna në bazë të tarifës së paraparë në Rregulloren Komunale mbi tarifat dhe ngarkesat. 2 .Sipërfaqet e lira publike dhe objektet të cilat më parë janë shfrytëzuar nga kompanitë e biznesit që kanë sipërfaqe të mëdha janë dhënë pas	Pasurit të cilat i kemi dhënë në shfrytëzim sipas asaj që cekëm në shtyllën e dytë, pronësia e të njëjtave nuk është e qartë por Komuna i ka marrë në menaxhim për ti mbrojtur nga abuzimet e ndryshme. Dhënia në përdorim kompanive të ndryshme është bërë për dy qëllime. 1. Që të mbrohet prona dhe objektet 2. Që ti ndihmohet zhvillimit të ekonomisë dhe punësimit.	Mbesin konstatimet e auditorit. Shlyerja e qerases dhe zbritja e lartësisë së tarifave shkakton jo transparencë dhe mosbarazim për paguesit tjerë të cilët kanë qenë të rregullt në pagesa ZRGJ rekomandon qe Menaxhmenti i Komunës fuqimisht të angazhohet të zbatoj në praktik kërkesat e LMFPP dhe të Rregullores mbi lartësinë e

	marrjes së vendimit, në Asamblenë Komunale për çdo objekt (hapësirë) veç e veç me tender publik. Kurse zbritjet e obligimeve Kompanive në shfrytëzim të këtyre hapësirave është bërë pasi që të njëjtat kanë kërkuar me arsyetim për afarizëm të dobët dhe në kontratën e nënshkruar fillimisht është paraparë që palët çmimit mund të negociojnë varësisht nga ecurit ekonomike të Kompanisë, si dhe investimet e bëra gjatë periudhës së shfrytëzimit nga ana e kompanisë është paraparë me kontratë që komuna ti merr parasysht.	Përveç inkasimit e të hyrave (rritjes së buxhetit komunal) gjatë kësaj periudha komuna ka përfituar në punësime të reja nga shfrytëzuesit e këtyre objekteve. Pronësia e këtyre dy objekteve është e paqartë.	tarifave, ngarkesave dhe kompensimeve për shërbime komunale 01Nr 13.
7	Rekomandimi rreth pikës 7 nuk qëndron i tëri .Rreth çmimit t'ju sqarojmë se komuna objektin e ka dhënë në shfrytëzim me qëllim që qiraja për dhjetë vite të jetë investim në rregullimin e objektit. d.m th-në Qiramarrësi Komunës i ka ofruar program për investim në objekt në vlerë prej 600.000,00DM, si kompensim i qirasë, për investim më të madh Komuna nuk ka kurrfarë obligimi. Ndërsa rreth vlerësimit të vlerës së investuar nga qiramarrësi është e vërtet se nuk është bërë ndonjë vlerësim nga ndonjë kompani apo personi fizik i pa varur po mendojmë se kjo do të bëhet në kohën kur komuna do ta marrë sërish këtë objekt në pronësi (menaxhim). Sa për një pasqyrë komuna ka bërë një shikim të dokumentacionit rreth investimit në këtë objekt nga një komision.	Të ju sqarojmë se objekti është dhënë në shfrytëzim në vitin 2001 dhe i njëjti pas dhjetë viteve i kthehet komunës. Sa për njoftim ky objekt kur është marrë nga komuna në menaxhim dhe kur është dhënë në shfrytëzim ka qenë në gjendje të mjerueshme, kurse, tani pamja e tij tregon se veprimi i komunës në këtë rast ka qenë i drejtë dhe i qëlluar. Pronësia e këtij objekti nuk është i qarët	Mbesin konstatimet e auditorit. Vlerësojmë gatishmërinë tuaj për implementimin e rekomandimeve tona
8	Rekomandimi pranohet mirëpo deri me tani bllok pagesat janë dërguar tek arkëtari pas çdo përfundimi të bllokut. Në të ardhmen të veprohet sipas rekomandimeve të auditorit. Pas çdo përfundimi të bllokut nuk janë bërë harmonizimet e të	Në të ardhmen përgjegjësit për inkasimin e të hyrave do të barazohen rregullisht sipas	Mbesin konstatimet e auditorit. Vlerësojmë gatishmërinë tuaj për implementimin e rekomandimeve tona
9	Pranohet rekomandimi: Edhe pas tërheqjes me gojë dhe me shkrim një numër i vogël i punëtorëve të pa përgjegjshëm kanë mbetur te shurdhur me kërkesat tona për kthimin bllok pagesave . Disa prej punëtorëve pasi që kanë marr bllok pagesat të cilat nuk i kanë kthyer të njëjtit punëtorë tani gjenden në pensione(dy nga ata ne lagjen e epërme te komunitet serbe) të tjerëve ju është bërë vërejtja e fundit që brenda një afati sa më kundërtën do te njoftohen organet kompetente komunale për këtë gjë me kohe janë te njoftuar autoritet kompetente komunale	Për bllokat të pa dorëzuara do të urdhërohet menaxhmenti i QKMF-së që të hap procedurën e përgjegjësisë. Në të ardhmen përgjegjësit për inkasimin e të hyrave do të barazohen rregullisht sipas rekomandimit tuaj	Mbesin konstatimet e auditorit. Vlerësojmë gatishmërinë tuaj për implementimin e rekomandimeve tona
10	Pranohet rekomandimi: Auditorëve gjeneralë nuk ishim në gjendje ti ofrojmë pasqyrën e mjeteve të tubuara nga participimi shkaku i saj sepse personeli i cili mbanë një evidence te tillë ditën kritike ishte në pushim të rregullt vjetorë.		Mbesin konstatimet e auditorit. Vlerësojmë gatishmërinë tuaj për implementimin e rekomandimeve tona

11	Rekomandimi pranohet pjesërisht: Programi për futjen e shënimeve për vizitat mjekësore të pacientëve e kemi marr te gatshëm nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mirëqenës sociale e cila ne fakte ka mangësi ne vete lidhur me regjistrimin participimit nga ana e pacientëve.	Do të kërkohej që programi i regjistrimit të t hyrave në shëndetësi të participimit të gjendet sa më adekuat në ministri apo në ndonjë komunë tjetër si model.	Mbesin konstatimet e auditorit. Menaxhmenti i Komunës është përgjegjës për krijimin e bazës se te dhënave ne te cilën komuna duhet te mbështetet për te dhënat nga participimi.
12	Pranohet rekomandimi: Në të kaluarën nuk kemi pasur kurrfarë instruksione për harmonizimin e librave të protokolleve mjekësore me bllok pagesa dhe raportet tjera financiare.	Do të kërkohej në të ardhmen që të bëhen harmonizimet e rregullta në mes të inkasantëve dhe arkës kryesore të QKMF-së.	Mbesin konstatimet e auditorit. Vlerësojmë gatishmërinë tuaj për implementimin e rekomandimeve tona
13	Punëtorë financiarë ishin në disa trajnime profesionale por ato ishin të mangët	Në QKMF inkasojnë apo bëjnë pagesat personeli i cili nuk është i paraparë për punë me financat, andaj duhet të ndryshohet praktika e deritanishme.	Mbesin konstatimet e auditorit. Vlerësojmë gatishmërinë tuaj për implementimin e rekomandimeve tona
14	Pjesërisht pranohet rekomandimi: Kjo përzierje e mjeteve të inkasuar nga tarifat e ndryshme është bërë pasi që kodet për regjistrimin e të hyrave nuk parashohin ndarje më të theksuar respektivisht nuk ka specifikim të detajuar rreth regjistrimit të të hyrave.	Në të ardhmen do të kërkohej nga thesari dhe MEF-i që të shtojë numrin e kodeve për regjistrimin e të hyrave, ose që të i sqarohet zyrtarit e të të hyrave për mënyrën e regjistrimit.	Mbesin konstatimet e auditorit. Vlerësojmë gatishmërinë tuaj për implementimin e rekomandimeve
15	Pjesërisht rekomandimi pranohet: Pasi që mjetet themelore të prekshme janë të regjistruara me të dhëna nga dokumentacioni ekzistues pranues(fletë dërgesa, faturat et.).	I rekomandohet menaxherit të pasurive që të përpiloj një formë e cila do të kishte të dhëna të mjaftueshme në rastin e regjistrimit të çdo mjeti themelor dhe e njëjta formë t'iu shpërndahet të gjithë nëpunësve te komunës të cilët janë të përfshirë në porosinë, blerjen dhe pranimit e mjetit themelor.	Mbesin konstatimet e auditorit. Vlerësojmë gatishmërinë tuaj për implementimin e rekomandimeve
16	Rekomandimi pranohet pjesërisht. Mjetet themelore të blera regjistrohen në bazë të vlerës që e kanë në faturë,(dokumentacionin përcjellës), ndërsa mjetet themelore që kanë qenë pa vlerë (të pavlerësuar) komisioni gjatë regjistrimi ka bërë një vlerësim me një vlerë, e cila mundet të jetë edhe jo reale. Me rastin e tjetërsimit të mjeteve komuna paraprakisht formon komision i cili cakton vlerën e përafërt, mirëpo zakonisht tjetërsimi bëhet përmes hapjes së tenderit publik dhe tregu është ai që cakton çmimin përfundimtar. Kontabilizimi i mjeteve ekziston për mjetet e blera dhe do të verifikojmë a është i mjaftueshëm,	Menaxherit të pasurive i rekomandohet që kontabilizimin e mjeteve themelore të prekshme të bëjë në përputhje të plotë me udhëzimin administrativë 2005/11 si dhe me praktikën e cila tani aplikohet në institucionet qeveritare të Kosovë.	Mbesin konstatimet e auditorit. Auditori ka vërejtë se Komuna nuk udhëheq evidenca complete për pasurin siç kërkohej me Standardet Kosovare të Kontabilitetit. Kështu nuk ka kartela specifike ku vërtetohet: Vlera e mjetit, kostoja e përvetësimit, jeta e përdorimit dhe zhvlerësimi i akumuluar dhe vlera e mbetur e mjetit ne funde te vitit. ZRGJ i rekomandon Menaxhmentit të Komunës të udhëheqë evidenca për pasurinë ne përputhje me kërkesat e Instruksionit Administrativ 2005/11 Mbi Menaxhimin dhe Regjistrimin e Pasurive Qeveritare dhe SKK.
17	Pranohet plotësisht rekomandimi i Auditorit Gjeneral.	Gjatë vitit 2008 Menaxheri i pasurive do të bëjë programin për regjistrimin individual të pasurive në	Mbesin konstatimet e auditorit. Vlerësojmë gatishmërinë tuaj për

		Komunën e Rahovecit.	implementimin e rekomandimeve
18	Pranohet rekomandimi tërësisht	Në të ardhmen do të kërkojmë që nga komisioni me rastin e regjistrimit të bëhet edhe llogaritja e amortizimit.	Mbesin konstatimet e auditorit. Vlerësojmë gatishmërinë tuaj për implementimin e rekomandimeve
19	Pranohet rekomandimi pjesërisht: Në vërejtjet e auditorit gjeneralë thuhet se me tepër janë dhënë barëra se sa janë pranuar. Arsyeja është se barërat e dhënë janë evidentuar si më tepër për shkak se donacionet e ndryshme si CIMIK-u gjermanë etj, nuk janë futur si barna në stoqe. Ndërsa sa i përket barnave me afate të skaduar kjo është një problem i cili bartet nga lufta e këndeve sepse ne nuk kemi pasur mundësi të bëjmë asgjësimin e tërë sepse për një punë të tillë duhet të merret vendimi nga Qeveria e Kosovës.	Në të ardhmen QKMF-ja duhet të regjistrojë të gjitha llojet e të hyrave në barëra pa marrë parasysh se janë ato donacion apo janë të hyra nga granti qeveritar i paraparë nga Qeveria. Të gjitha barnat në deponë e vjetër me afat të skaduar e që janë nga lista esenciale e barnave të evidentohet.	Mbesin konstatimet e auditorit. ZRGJ rekomandon që Komuna duhet të udhëheqë evidenca të sakta, complete dhe gjithëpërfshirëse për tërë pasurinë me të cilën disponon (të blerë apo të dhuruar).
20	Pranohet plotësisht rekomandimi: Sqarim: Menaxhmenti i Komunës ka përgatitur një rregullore në formë të draftit për mënyrën e përdorimit të auto veturave pronë e Kuvendit Komunal, mirëpo Asambleja Komunale nuk e ka aprovuar, Bordi i drejtorëve me një vendim kanë bërë ndarje nëpër drejtori. Rreth shpenzimit të derivateve bordi i drejtorëve që para tre viteve ka bërë një vendim i cili në praktik aplikohet kështu: Shkuarja-ardhja për Prishtinë pranohen 20 litra, për Prizren 10 litra etj.	Menjëherë pas vërejtjes nga ju edhe përkundër që ende nuk është aprovuar rregullorja nga asambleja Komunale, bordi i drejtorëve ka marrë vendim që të gjitha autoveturat të mbahen në autopark dhe është caktuar personi përgjegjës i autoparkut.	Mbesin konstatimet e auditorit. Vlerësojmë gatishmërinë tuaj për implementimin e rekomandimeve
21	Pranohet rekomandimi: Në dosjet e personelit mungojnë disa vendime dhe dokumente të tjera të nevojshme për krijimin e pasqyrës së saktë për të punësuarit.	Zyrës së personelit i rekomandohet që të gjitha dokumentet e nevojshme që me kohë ti depozitojë në dosjen e çdo punëtori, sipas ligjit respektivisht aktit nënligjor mbi krijimin e dosjes të punësuarve në sektorin publik.	Mbesin konstatimet e auditorit. Vlerësojmë gatishmërinë tuaj për implementimin e rekomandimeve
22	Pranohet rekomandimi. Por blerja e dhuratave është bërë në fund të vitit në periudhën kur çështja e zotimit ka qenë e pamundur: blerja e dhuratave është paguar nga pozicioni i subvencioneve. Ndërsa rreth furnizimit me material të zyrës pranohet tërësisht.	Gjatë vitit 2007 është tentuar maksimalisht që të bëhet zotimi i mjeteve para fillimit të procedurës së prokurimit për furnizimet e ndryshme.	Mbesin konstatimet e auditorit. Vlerësojmë gatishmërinë tuaj për implementimin e rekomandimeve
23	Pranohet rekomandimi mirëpo zyrtar i prokurimit njëkohësisht është edhe zyrtar i autorizuar me aktvendim të veçanta si zyrtar pranues për shpenzimet e kryera në pozicionin investime kapitale.	Në të ardhmen do të kemi parasysh që persona të mos jenë të njëjtë.	Mbesin konstatimet e auditorit. Vlerësojmë gatishmërinë tuaj për implementimin e rekomandimeve
24	Pranohet rekomandimi: Sigurisht që zyrtari i prokurimit ka bërë gabim teknik përndryshe kontrata janë 1 vjeçare .	I rekomandohet zyrës së prokurimit që të mos bëjë gabimet e tilla në punët e ardhshme.	Mbesin konstatimet e auditorit. Vlerësojmë gatishmërinë tuaj për implementimin e rekomandimeve
25	Rekomandimi pranohet pjesërisht Kemi qenë të detyruar të i marrim të ky furnizues pasi që kemi pas kontratë me të dhe ka qenë i vetmi	Në të ardhmen duhet që MASHT-i duhet me kohë të bëjë me kohë njoftimin e komunave për kompanitë e	Mbesin konstatimet e auditorit. Autoriteti kontraktues domosdoshmërisht

	furnitorë i autorizuar për furnizim me ditarë klase .Në këtë vit furnizimi është bërë sipas tenderit	certifikuara për shtypjen dhe distribuimi e materialit shkollor.	kërkohej që çdo artikull që do të blej ta përfshijë në specifikim teknik dhe kontratë, me qëllim që çmimet për këto artikuj të jenë të ofruar përmes konkurrencës së plotë dhe transparente
26	Rekomandimi nuk është i qartë për shkak se nuk është cekur në mënyrë të saktë se në cilët prej furnizimeve nuk ka pasur raport të pranimi të mallit. Përndryshe në bazë të rregullores për ekzekutimin e pagesave pran thesarit në MEF asnjë pagesë nuk mundet të bëhet pa e pasur ë bashkangjitur raportin mbi pranimin e mallit.	I rekomandohet zyrës së prokurimit që ti bën rrumbullajtjen e këtyre raporteve (gjithë dokumentacionit) në dosjen e Tenderit	Mbesin konstatimet e auditorit. E gjetura e Auditorit ka të bëjë me mostrën Furnizim me material zyre në vlerë prej 14,719 euro.
27	Pranohet rekomandimi pjesërisht Sipas zyrtarit të prokurimit dokumenti i nënshkruar nga dy anëtarë të komisionit konsiderohet valid.	I rekomandohet zyrës së prokurimit që në të ardhmen të mos bëjë lëshime respektivisht raportet të jenë të nënshkruara nga të gjithë anëtarë të komisionit.	Mbesin konstatimet e auditorit. Auditori ka vërejtur një vrugë devijimesh te kjo mostër. Si dëshmi për të mbështetur opinionin e tij për devijimet(parregullësit e konstatuara)ka potencuar edhe mos nënshkrimin e Raportit të vlerësimit nga njëri nga anëtarët e Komisionit të vlerësimit, duke pasur parasysh mos lënien e dëshmisë për arsyet e mos nënshkrimit.
28	Rekomandimi pranohet me një sqarim:Komuna e Rahovecit ka mungesë të kuadrit profesional në lëmin teknike për këtë arsye ka ardhur deri te ky lëshim.	Në të ardhmen duhet të merret parasysh maksimalisht që të mos ndodhë kjo.	Mbesin konstatimet e auditorit. Vlerësojmë gatishmërinë tuaj për implementimin e rekomandimeve
29	Rekomandimi pranohet pjesërisht sepse procesverbali standard i vlerësimit mungon ndoshta mundë të jetë i shmangur, mirëpo në librin ku mbahet evidenca e vlerësimit të çdo tenderi ekziston procesi me emra dhe mbiemra dhe nënshkrime.	Zyra e prokurimit duhet në të ardhmen të ketë kujdes në ruajtjen e dosjes të çdo tenderi.	Mbesin konstatimet e auditorit. Auditori në Dosjen e tenderit nuk ka hasë në Procesverbalin e vlerësimit të ofertave. Mungesa e dëshmive në Dosjen e tenderit nuk përshtaten me dispozitat e nenit 9.1 të LPP të cilat kërkojnë që”Autoriteti kontraktues mban një përmbledhje të rregulluar dhe gjithëpërfshirëse të të dhënave për secilin aktivitet të prokurimit që e kryen,pa marrë parasysh nëse aktiviteti i tillë rezulton në dhënie e kontratës ose konkursit të projektimit” si dhe dispozitat e nenit 27 të LPP të cilat kërkojnë që”Për secilën kontratë publike të propozuar,përveç një kontrate me vlerë minimale,autoriteti kontraktues do të

			përpilojë një dosje të tenderit që ofron informata përkatëse lidhur me kontratën në fjalë, duke përfshirë të gjitha termat dhe kushtet materiale të saj, procedurat e zbatueshme të prokurimit, çfarëdo kërkesë të aplikueshme të përshtatshmërisë ose ndonjë kriter të përzgjedhjes, procedurat e ankesës si dhe informatat e tjera përkatëse siç kërkohen nga ky ligj ose siç i sheh të domosdoshme autoriteti kontraktues”.
30	Pranohet rekomandimi	Zyra e prokurimit në të ardhmen duhet të bëjë caktimin e komisioneve me vendime të veçanta.	Mbesin konstatimet e auditorit. Vlerësojmë gatishmërinë tuaj për implementimin e rekomandimeve
31	Rekomandimi nuk pranohet për arsye se nuk dihet se për cilën kontratë është fjala. Zakonisht për çdo kontratë të investimeve kapitale caktohet menaxheri i projektit.		Mbesin konstatimet e auditorit. E gjetura e Auditorit ka të bëjë me mostrën Rrethimi i varrezave ortodokse në Rahovec në vlerë 15,998.70 euro, e cila gjendet në Aneks, nr rendor 31.
32	Zyra e prokurimit thotë i ka të gjitha kopjet e dokumenteve për pranimin e naftës.	I rekomandohet zyrës së prokurimit që në rastin e çdo auditimi ti prezantohet auditorit dokumentet me kohë.	Mbesin konstatimet e auditorit. Auditori ka vërejtur se mungon e evidenca analitike të pranimin të derivateve, pas furnizimit. Gjithashtu nuk ka ndonjë dëshmi të pranimin dhe kontrollit të cilësisë dhe sasisë se naftës.
33	Pranohet rekomandimi. Për shkak se Komuna ka mungesë të stafit profesional .	Menaxhmenti i ardhshëm i komunës do të kujdeset për pranimin e punëtorëve profesionalisht të ngritur.	Mbesin konstatimet e auditorit. Vlerësojmë gatishmërinë tuaj për implementimin e rekomandimeve
34	Pranohet rekomandimi DKA në vitin 2007 ka eliminuar këtë parregullsi ku pos drejtoritë shkollës ka qenë edhe punëtori teknik dhe një arsimtarë	Në të ardhmen duhet të mos tolerohen gabimet e tilla.	Mbesin konstatimet e auditorit. Vlerësojmë gatishmërinë tuaj për implementimin e rekomandimeve
35	Pranohet rekomandimi pjesërisht: Edhe pse është paraparë me kontratë të merret parasysh ndryshimi i çmimeve në BERZE është dashur që të verifikohet ndryshimi i çmimit.	Në të ardhmen zyra e prokurimit duhet të vërtetojë strikt ndryshimet në BERZE përmes burimeve të besueshme.	Mbesin konstatimet e auditorit. Vlerësojmë gatishmërinë tuaj për implementimin e rekomandimeve
36	Pranohet rekomandimi: Sigurisht që dokumenti është humbur nga ana e zyrës së prokurimit sepse çdo herë procedurat e prokurimit fillojnë me kërkesën e bërë nga drejtoritë përkatëse për fillimin e procedurave dhe vendimit për inicim nga ana e kryeshefit ekzekutiv.	I rekomandohet zyrës së prokurimit që dokumentacioni të ruhet rigorozisht në dosjen e tenderit pa marrë parasysh që ky dokumentacion shpesh është cak i kontrollimeve të ndryshme.	Mbesin konstatimet e auditorit. Vlerësojmë gatishmërinë tuaj për implementimin e rekomandimeve

37	Rekomandimi është njëjtë si te pika 28.		Mbesin konstatimet e auditorit. Vlerësojmë gatishmërinë tuaj për implementimin e rekomandimeve
38	Rekomandimi është i njëjtë sikurse te pika 29.		Mbesin konstatimet e auditorit. Vlerësojmë gatishmërinë tuaj për implementimin e rekomandimeve
39	Pranohet rekomandimi pjesërisht: Është dashur që auditori të specifikojë se për cilën lëndë është fjala.	Do të shikohet që në të ardhmen të mos lejohet esesi një veprim i tillë.	Mbesin konstatimet e auditorit. E gjetura e Auditorit ka të bëjë me mostrën Furnizim me Derivatet e naftës në vlerë 74,000 euro me nr rendor 39.
40	Furnizimi me dhurata është bërë në fund të vitit dhe e njëjta fillimisht është menduar të paguhet nga pozicioni mallra dhe shërbime por më vonë me kërkesën e thesarit është bërë nga pozicioni i subvencioneve.	Në të ardhmen duhet që çështja e blerjes së dhuratave të procedohet me kohë.	Mbesin konstatimet e auditorit. Vlerësojmë gatishmërinë tuaj për implementimin e rekomandimeve.
41	Nuk ka koment.		Mbesin konstatimet e auditorit. Vlerësojmë gatishmërinë tuaj për implementimin e rekomandimeve
42	Nuk ka koment.		Mbesin konstatimet e auditorit. Vlerësojmë gatishmërinë tuaj për implementimin e rekomandimeve
43	Rekomandimi pranohet pjesërisht: Njëjtë si në rastet tjera raporti është shmangë. Pagesa nuk ishte kryer po të kishte munguar raporti mbi kryerjen e punimeve.	I rekomandohet Zyrës së prokurimit të ruaj me kujdes materialin në dosje të secilit tender.	Mbesin konstatimet e auditorit. Përgjigja si në pikën 29 të Aneksit 2.
44	Nuk ka koment.		Mbesin konstatimet e auditorit. Vlerësojmë gatishmërinë tuaj për implementimin e rekomandimeve
45	Rekomandimi është me vend, Zyrtari zotues ka bërë gabim në përshkrimin e zotimit.	Rekomandim zyrtarëve përgjegjës që me rastin e përshkrimit të veprimeve të jenë të kujdesshëm.	Mbesin konstatimet e auditorit. Vlerësojmë gatishmërinë tuaj për implementimin e rekomandimeve
47	Rekomandimi pranohet pjesërisht: Rishikimi i projektit nuk është bërë të jemi të sigurtë komuna asnjëherë nuk ka bërë revidim të projekteve para ekzekutimit .Motivi ka qene kursimi i buxhetit. Rishikimi është bërë më kërkesën e Donatorit kompanisë CIMIC-ut Gjerman.	Në të ardhmen komuna do të ketë parasysh këtë vërejtje.	Mbesin konstatimet e auditorit. Auditori ka konstatuar se Komuna nuk ka vlerësuar dhe rishikuar projektin te cilin komuna e ka marrë falas nga komuniteti i fshatit, dhe erdhi deri te fillimi i punimeve në vend të gabueshëm. Po ashtu kjo ka sjellë dëmtim të buxhetit si dhe zvarritje të punimeve.
48	Rekomandimi pranohet: Kjo është bërë më qëllim që mjetet të	Nuk do të përsëritet në të ardhmen. Objekti në fjalë	Mbesin konstatimet e auditorit.

	shpenzohen në fund të vitit dhe operatori ka qenë i njohur për Komunën.	është kryer sipas kontratës.	Vlerësojmë gatishmërinë tuaj për implementimin e rekomandimeve
49	Pranohet rekomandimi pjesërisht : Është e vërtetë se pagesa në vlerë prej 50,000 euro i është paguar operatorit ekonomik për një pjesë për punët e kryera, në fakt vlera e punimeve nuk e ka arritur vlerën e pagesës, që do të thotë se një pjesë e pagesës mund të llogaritet si paradhënie (avansë).		Mbesin konstatimet e auditorit. Pagesa e kontraktorëve pa i kryer obligimet sipas kontratave, përpos që është në kundërshtim me nenin 7.1 të Rregulla Financiare dhe Udhëzimet e Thesarit – 02 Shpenzimi i Parave Publike, mund të shkaktojë mos përmbushje të obligimeve në cilësinë e paraparë me kontratë dhe vonesë në kryerjen e punëve, pasi që komuna nuk ka më fuqi për realizimin e kontratës. Veç kësaj komuna merr një rrezik të madhe financiar me këto pagesa në avans në rast se kompanitë dështojnë në kryerjen e punëve.
50	Rekomandimi pranohet pjesërisht: rreth punëve shtesë operatori ekonomik është konsultuar me menaxherin e projektit mirëpo procedurat e nevojshme nuk janë kryer me kohë dhe për këtë arsye Komuna nuk ka qenë në gjendje të bëjë pranimin e punëve shtesë.	I rekomandohet menaxherit të projektit dhe zyrës së prokurimit që në të ardhmen procedurat për punë shtesë të kryhen me kohë në bashkëpunim me Agjencionin e prokurimit publik.	Mbesin konstatimet e auditorit. Moskryerja me kohë e procedurave të nevojshme si për Aneks marrëveshje apo sigurimi i aprovimit nga APP-ja paraqet devijim nga kërkesat e neneve 8.1;34.1;34.2-d;34.3;34.4 të LPP-së drejton te ajo se janë krijuar dhe imponuar rrethana për eliminimin konkurrencës, transparencës, përdorim jo të drejtë të fondeve publike me qëllim që të favorizojë dhe shpërblejë me kontratë kryesin e punimeve. ZRGJ i rekomandon Menaxhmentit të Komunës që dispozitat e neneve të cekura më lartë të LPP-së domosdoshmërisht të zbatohen në praktikë.
51	Ndryshimi i pozicioneve në objektin në fjalë janë bërë më pëlqimin e organit mbikëqyrës, Të gjitha ndryshimet e bëra janë pjesë e ndryshimit edhe të çmimit respektivisht në (barazimin financiar), çdo material i ndryshuar ka çmimin e vetë.	Menaxheri i projektit (mbikëqyrësi) në të ardhmen duhet të gjitha çështjet ndryshuara gjatë ekzekutimit të punimeve të paraqes në të gjitha librat dhe të njëjta të barazojë me operatorin ekonomik, zyrën e prokurimit dhe organet tjera të nevojshme sipas ligjit.	Mbesin konstatimet e auditorit. ZRGJ rekomandon që për të gjitha ndryshimet e bëra dëshmitë përkatëse duhet të bashkëngjiten në dosjen e tenderit në pajtim me rregullat e neneve 9.1 dhe 27 të LPP-së.
52	Rekomandimi është me vend por kjo ka ndodhur pasi që Komuna nuk i ka pasur mjetet e mjaftueshme financiare. Dhe njëkohësisht me rastin		Mbesin konstatimet e auditorit. Vlerësojmë gatishmërinë tuaj për

	e revidimit të projektit dhe pëlqimit nga KEK-ut komuna është detyruar të bëjë zhvendosjen e objektit për 15 metra që ka ndikuar në vonesën e kryerjes së objektit me kohë		implementimin e rekomandimeve
53	Rekomandimi i dhënë në këtë pozicion i duhet sqarim: Komuna nuk ka paguar asnjë pune shtesë, ndërsa asfaltimi i rrugës për në shkollë dhe i oborrit të shkollës nuk është kryer pasi që me ato mjete komuna ka paguar pozicionet të tjera në objekt. Para masa për rrugën dhe oborrin e shkollës ka shërbyer për tërheqjen e mjeteve në fund të vitit 2006, nga mjetet e qeverisë së Kosovës. Meqë që këto mjete janë tërhequr në emër të oborrit dhe rrugës meqë ishte fundi i vitit, ishte e pamundur të kryhen komplet procedurat e prokurimit, andaj të njëjtat mjete janë shfrytëzuar për pagesën e situacioneve më lartë. Kurse mjetet e parapara në vitin 2007 për vazhdimin e shkollës së mesme janë dedikuar për rregullimin e rrugës që qon drejt në oborr të shkollës dhe i njëjti projekt është realizuar në tremujorin e vitit 2007.	Komuna këtyre ditëve ka përfunduar edhe asfaltimin e rrugës dhe oborrit të kësaj shkollë.	Mbesin konstatimet e auditorit. Tërheqja e mjeteve të BKK-së pa u kryer punët për atë çka janë paraparë paraqet mosrespektim të dispozitave të nenit 7.1 dhe 7.2 të Rregulla Financiare dhe Udhëzimet e Thesarit – 02 Shpenzimi i Parave Publike të cilat kërkojnë që të gjitha organizatat buxhetore duhet të kenë dëshmi të dokumentuara që janë kryer shërbimet para se të bëhet pagesa e fondeve publike për një furnizues si dhe Zyrtaari kryesor financiar është përgjegjës për të siguruar që të gjitha faturat valide janë paguar.
54	Rekomandimi është i pranuar: Rreth nënshkrimit të raportit të pranimit teknikë një sqarim. Përfaqësuesit e Kompanisë CIMIC-ut janë deklaruar se pasi që ata kanë marrë pjesë në këtë tender me një shumë të vogël të mjeteve (nuk janë financuesi kryesorë) ata kanë kërkuar të jenë vetëm si vëzhgues e jo anëtarë fuqiplotë të komisionit. Kurse mos nënshkrimi i njërit anëtarë nuk është bërë për arsye se ka qenë anëtarë i komisionit për vlerësimin e këtij tenderi dhe është zyrtar pranues për investime kapitale. Zotimi i mjeteve nuk është bërë më kohë në sasi të mjaftueshme. Kërkesën për caktimin e lokacionit e kemi iniciuar pas kërkesës së CIMIC-ut për pëlqim nga KEK-u, i cili ka kërkuar largimin e objektit nga largpërçuesi. Më herët është shpjeguar se mjetet e marra për asfaltimin e rrugës dhe oborrit janë përdorur për këtë pozicion pasi që këto mjete kane pasur vetëm 15 dite afate për shpenzim	Komuna në të ardhmen do të i merr shumë seriozisht vërejtjet dhe do të i kushtoj vëmendje dokumentacionit dhe procedurave ligjore,	Mbesin konstatimet e auditorit. Vlerësojmë gatishmërinë tuaj për implementimin e rekomandimeve
55	Pa koment.		Mbesin konstatimet e auditorit. Vlerësojmë gatishmërinë tuaj për implementimin e rekomandimeve
56	Pranohet rekomandimi: Punimet janë bërë me urgjencë për shkak të situatës së krijuar nga vërshimet e krijuar në mars të vitit 2006.	Në të ardhmen do të eliminohen këto mangësi.	Mbesin konstatimet e auditorit. Vlerësojmë gatishmërinë tuaj për implementimin e rekomandimeve
57	Pranohet rekomandimi : Nuk ka koment.		Mbesin konstatimet e auditorit. Vlerësojmë gatishmërinë tuaj për

			implementimin e rekomandimeve
58	Rekomandimi pranohet pjesërisht Është e mundur që ndonjë faturë ka shpëtuar pa u nënshkruar, zakonisht pagesat nuk mund të kryhen në thesar pa i pasur të gjitha nënshkrimet.	I rekomandohet zyrës së prokurimit dhe përgjegjësit që në të ardhmen ti prezantojnë dokumentacionin e nënshkruar auditorëve.	Mbesin konstatimet e auditorit. Vlerësojmë gatishmërinë tuaj për implementimin e rekomandimeve
59	Rekomandimi pranohet pjesërisht Zotimi i mjeteve nuk është bërë pasi që kontrata është me afat njëvjeçar dhe zakonisht për shërbime një vjeçare nuk e kemi bërë zotime paraprake.	Në të ardhmen do të bëhet zotimi me kohë.	Mbesin konstatimet e auditorit. Vlerësojmë gatishmërinë tuaj për implementimin e rekomandimeve
60	Nuk ka koment.		Mbesin konstatimet e auditorit. Vlerësojmë gatishmërinë tuaj për implementimin e rekomandimeve
61	Komenti është i dhënë në pikën 43		Mbesin konstatimet e auditorit. Përgjigja në koment si në piken 43 të Aneksit 2
62	Pranohet rekomandimi: Pagesën e kemi bërë në maj të vitit 2006 pasi që nuk kemi pasur buxhet dhe sigurisht faturat janë prezantuar me vonesë. Zakonisht nuk kemi bërë specifikacion.	Rekomandohet që për shpenzimet e tilla në të ardhmen të aplikohet specifikacionin i mysafirëve dhe qëllimi i drekës zyrtare.	Mbesin konstatimet e auditorit. Vlerësojmë gatishmërinë tuaj për implementimin e rekomandimeve